FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 142

Tiranë – E premte, 5 tetor 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 576, datë 3.10.2018	Për miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane" (truall) të pasurive nr. 94/63, zona kadastrale 3221, Bashkia Maliq, dhe nr. 17/13, zona kadastrale 3690, Bashkia Durrës.....	9549
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 580, datë 3.10.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 337, datë 22.4.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", të ndryshuar.....	9554
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 581, datë 3.10.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 253, datë 6.3.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave bujqësore", të ndryshuar.....	9554
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 583, datë 3.10.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 22, datë 12.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kritereve për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit".....	9555
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 665, datë 4.10.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 837, datë 10.2.2017, të ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, "Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve".....	9556
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 390, datë 18.9.2018	Për miratimin e kontratës tip ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Organizatave të Menaxhimit të Peshkimit për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në zonat bashkëmenaxhuese të peshkimit.....	9557

Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 660, datë 20.9. 2018	Për miratimin e rregullores mbi praktikat e ruajtjes dhe shpërndarjes së mirë të barnave.....	9562
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 22.5.2018	Çështja "Malo kundër Shqipërisë" *(kërkesa nr. 72359/11)*	9575
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 22.5.2018	Çështja "Muça kundër Shqipërisë" *(kërkesa nr. 57456/11)*	9579
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 22.5.2018	Çështja "Hysi kundër Shqipërisë" *(kërkesa nr. 72361/11)*	9584

VENDIM
Nr. 576, datë 3.10.2018

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT NGA KATEGORIA E RESURSIT "TOKË BUJQËSORE" NË "TOKË URBANE" (TRUALL) TË PASURIVE NR. 94/63, ZONA KADASTRALE 3221, BASHKIA MALIQ, DHE NR.17/13, ZONA KADASTRALE 3690, BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane" (truall) të pasurive nr. 94/63, zona kadastrale 3221, Bashkia Maliq, dhe nr. 17/13, zona kadastrale 3690, Bashkia Durrës, sipas lidhjes nr. 1, certifikatave të pasurisë dhe hartave treguese, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, qarku Korçë dhe qarku Durrës, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit nga "tokë bujqësore" në "tokë urbane" (truall) të pasurive nr. 94/63, zona kadastrale 3221, Bashkia Maliq, dhe nr.17/13, zona kadastrale 3690, Bashkia Durrës.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Korçë, Këshilli i Qarkut Durrës, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

Nr. rendor	Qarku	Bashkia	Zona kadastrale	Adresa e pasurisë	Numri i pasurisë	Sipërfaqja m²	Pronari
1	Korçë	Maliq	3221	Rembec	94/63	2034	Margel Agolli
2	Durrës	Durrës	3690	Vadardhe	17/13	4610	AGS sh.p.k.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 1461574

PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit DURRËS Zona Kadastrale Nr. 3690

Numri i Pasurisë 17/13 Volumi 6 Faqe 61

Adresa e Pasurisë VADARDHE

Lloji i Pasurisë ARË

Sipërfaqja Totale 4610 m²

Nga kjo : Sa Truall – Nga kjo : Sa Ndërtesa –

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes – %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
AGS.	SHPK.		I	VADARDHE

- është pronar i 17/13
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart –
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi –
- kufizimet e pasurisë janë : V ____, L ____, J ____, P ____

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë ____ Nr. ____

Lëshuesi i çertifikatës

REGJISTRUESI

ADRIAN KONA

Data e lëshimit të çertifikatës

12.07.2018


HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME
DURRES
A. IDENTIFIKIMI I PASURISE
ZONA KADASTRALE 3690 NR.PASURISE 17/13 Vol. 8 FQ 61
INDEKSI I HARTES K-34-88-(194-A) SHKALLA 1:2500 SIP = 4610m²
ADRESA E PASURISE : Rrethi Durres Q/F JADARDHE
Rr/L — P/G — Sh — K — Ap —
REGJISTRUESI I RRETHIT
ANI DYRMISHI
B. KUFIZIME
V. PASURIA Nr 112
L. PASURIA Nr 112
J. PASURIA Nr 98;113
P. PASURIA Nr 17/14
D. Data 07 / 04 / 2017 Ora 11 30
C. PRONARI
AGRO INTERNATIONAL SH.P.K
REPUBLIKA E SHQIPERISE ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME
Z.V.R.P.P DURRES
16/6
17/10
17/11
17/13
87.50
87.75



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 1394823

PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. KORCË Zona Kadastrale Nr. 3221

Numri i Pasurisë 94/63 Volumi 10 Faqe 81

Adresa e Pasurisë REMBEC

Lloji i Pasurisë ARE

Sipërfaqja Totale 2034.00 m2

Nga kjo : Sa Truall Nga kjo : Sa Ndërtesa

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
MARGEL	VALENT	AGOLLI	1/1	

- është pronar i pasurisë me numër 94/63
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V 94/22, L 94/54, J 94/24, P 135

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Data e lëshimit të çertifikatës

27/7/2016

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t)

më datë 30/12/1899 Nr. 11352

Lëshuesi i çertifikatës

REGJISTRUESI

KLAJDI TËROVA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME Z.V.R.P.P. KORCË

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT



VENDIM
Nr. 580, datë 3.10.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 337, DATË 22.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË KRYERJES SË PROCESIT TË KALIMIT TË TOKËS BUJQËSORE TË ISH-NDËRMARRJEVE BUJQËSORE NË PRONËSI TË PËRFITUESVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 337, datë 22.4.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Përdoruesit faktikë të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore, të cilët nuk janë pajisur me AMTP-në, paraqesin në njësinë administrative, në juridiksionin territorial të së cilës gjendet toka bujqësore:".

b) Në shkronjën "b", shtohet fjalia e dytë, me këtë përmbajtje:

"Në rastet kur përdoruesit faktikë janë në pamundësi financiare për hartimin e planvendosjes së ngastrave të tokës bujqësore që kanë në përdorim, ato kryhen me shpenzimet e bashkive, nëpërmjet topografëve të tyre.".

2. Në pikën 3 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

a) Paragrafi i parë i pikës 3 ndryshohet me këtë përmbajtje:

"Subjektet e përcaktuara si bashkëthemeluese të ish-ndërmarrjes bujqësore, sipas vendimit nr. 452, datë 17.10.1992, të Këshillit të Ministrave, "Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore", të ndryshuar, të cilat nuk janë pajisur me AMTP-në për tokën bujqësore që kanë në përdorim faktik, paraqesin në njësinë administrative, në juridiksionin territorial të së cilës gjendet toka bujqësore:".

b) Në shkronjën "c" shtohet fjalia e dytë, me këtë përmbajtje:

"Në rastet kur përdoruesit faktikë janë në pamundësi financiare për hartimin e planvendosjes së ngastrave të tokës bujqësore që kanë në përdorim, ato kryhen me shpenzimet e bashkive, nëpërmjet topografëve të tyre.".

3. Në pikën 22, fjalët "... nga një subjekt i licencuar ...", hiqen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 581, datë 3.10.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 253, DATË 6.3.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË PLOTËSIMIT TË AKTEVE TË MARRJES SË TOKËS BUJQËSORE NË PRONËSI PËR FAMILJET BUJQËSORE NË FSHATRAT E ISH-KOOPERATIVAVE BUJQËSORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 253, datë 6.3.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 2 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë vijon:

"2. Përdoruesit faktikë të tokës bujqësore të ish-kooperativave bujqësore, të cilët nuk janë pajisur me AMTP, paraqesin në njësinë administrative, në

juridiksionin territorial të së cilës gjendet toka bujqësore: ...".

b) Në shkronjën "b" shtohet fjalia e dytë, me këtë përmbajtje:

"Në rastet kur përdoruesit faktikë janë në pamundësi financiare për hartimin e planvendosjes së ngastrave të tokës bujqësore që kanë në përdorim, ato kryhen me shpenzimet e bashkive nëpërmjet topografëve të tyre; ...".

2. Në pikën 21, fjalët "... nga një subjekt i licencuar ...", hiqen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 583, datë 3.10.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 22, DATË 12.1.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR CERTIFIKIMIN E VEPRIMTARISË SË AGROTURIZMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, pika 2, e 44, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, dhe të neneve 8 e 10, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 22, datë 12.1.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Titulli i vendimit ndryshon dhe bëhet: "Për miratimin e kritereve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij".

2. Titulli i kreut II ndryshon, si më poshtë vijon:

"II. Kriteret dhe procedurat për certifikimin e veprimtarisë pritëse si "agroturizëm" dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të agroturizmit".

3. Pas pikës 8, të kreut II, shtohen pikat 8/1, 8/2 dhe 8/3, me këtë përmbajtje:

"8/1. Kriteret e përcaktuara në këtë vendim shërbejnë dhe janë të detyrueshme për zbatim nga ana e autoriteteve përgjegjëse të planifikimit dhe zhvillimit të territorit për hartimin e dokumenteve të planifikimit në të gjitha nivelet.

8/2. Leja e ndërtimit lëshohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me dokumentin e planifikimit vendor.

8/3. Në kushtet e mungesës së planit të përgjithshëm vendor:

a) Kriteret e përcaktuara në këtë vendim janë kushtet minimale për pajisjen me leje;

b) Leja e ndërtimit lëshohet nga bashkia, pas kontrollit të përputhshmërisë të projektpropozimit nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), e cila, në bashkërendim me ministrinë përgjegjëse për turizmin verifikon përputhshmërinë me dokumentet e planifikimit të territorit në fuqi;

c) AZHT-ja njofton bashkinë përkatëse dhe aplikantin për kontrollin e përputhshmërisë dhe vazhdimin e mëtejshëm të procedurave;

ç) Bashkia kryen verifikimin në terren, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi për planifikimin e territorit, përfshirë edhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim dhe njofton AZHT-në;

d) Në rast se, si pasojë e verifikimeve në terren, rezulton se propozimi është në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas këtij vendimi dhe dokumentet e planifikimit të territorit në fuqi, kryetari i bashkisë merr vendim për miratimin e lejes së ndërtimit. Në rastet kur është i nevojshëm ndryshimi i kategorisë së resursit të tokës ku ndërtohet struktura e agroturizmit, në kategorinë e resursit "truall", bashkia i propozon ministrisë përgjegjëse të vijojë procedurat për ndryshimin e kategorisë së resursit të sipërfaqes së tokës, objekt i lejes së ndërtimit. Ministra përgjegjëse, më pas, harton projektvendimin, të cilin e paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave;

dh) Pas miratimit të kalimit të tokës në sipërfaqe ndërtimore, bashkia i dorëzon aplikuesit dokumentin e lejes dhe e boton atë në regjistrin e integruar të planifikimit të territorit.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 665, datë 4.10.2018

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 837, DATË 10.2.2017, TË MINISTRIT TË TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS, "PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR SHPËRNDARJEN DHE PËRDORIMIN E SUBVENCIONEVE SHTETËRORE PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE NË SEKTORIN E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të germës "ç", të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.7.2018, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin e ministrit nr. 837, datë 10.2.2017, lidhja nr. 1, zëvendësohet me lidhjen A bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, të gjitha bashkitë, të gjithë sh.a. ujësjellës-kanalizime.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjiknuri

Lidhja A

METODOLOGJI
PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR SHPËRNDARJEN DHE PËRDORIMIN E SUBVENCIONEVE SHTETËRORE PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE NË SEKTORIN E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE

Kjo metodologji është hartuar në zbatim të germës "dh", të pikës 13, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.7.2018, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve", dhe në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, detajimi i fondit të subvencionit për çdo shoqëri aksionare të ujësjellës-kanalizimeve (sh.a. UK) dhe përdorimi i tij nga përfituesit, do të bëhet si më poshtë:

1. Subvencioni do të shpërndahet nga AKUM-ja në masën e planifikuar në ligjin vjetor të buxhetit dhe të gjitha shtesave të tjera të bëra me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Vlerësimi i nevojave për subvencione, si dhe detajimi dhe shpërndarja e subvencionit nga AKUM-ja, do të bazohet në:

2.1 Të dhënat e raportuara nga ofruesit e shërbimeve sh.a. UK, pranë AKUM-së, në përputhje me kërkesat, formatin dhe afatet e përcaktuara.

2.2 Në ecurinë e përmbushjes së kritereve të përcaktuara në kontratat e performancës, lidhur ndërmjet palëve (AKUM-ja e bashkisë përkatëse).

3. Subvencioni i përfituar sipas pikës 1 të kësaj metodologjie do të përdoret nga sh.a. UK:

3.1 Për të përballuar mbulimin e "Kostos direkte të operimit (KDO)" (diferencën = faturime – kosto direkte e operimit), për të tria shërbimet publike që ofrohen në sektor: a) furnizim me ujë të pijshëm; b) kanalizime; c) trajtim e përpunim të ujërave të ndotura;

3.2 Për të mbështetur përmirësimin e performancës së sh.a. UK që operojnë në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve.

4. Skema e ndarjes së fondeve për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikën 3, pas hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi do të jenë:

4.1 40% e fondit të përgjithshëm të subvencionit do të shkojë për mbulimin e "Kostos direkte të operimit" (në rastet e shoqërive me vlerë negative të diferencës së të ardhurave të faturuara - KDO).

4.2 60% e fondit të përgjithshëm do të shkojë për nxitjen e performancës së shoqërive, pavarësisht diferencës së kostos, bazuar në:

a) Pikët e arritura nga vlerësimi i treguesve të performancës së tyre në krahasim me objektivat. Për këtë, AKUM-ja harton matricën e performancës, ku liston pikët e realizueshmërisë për secilën sh.a. UK, të kontratës së performancës.

b) Në numrin e popullsisë së shërbyer.

5. Përjashtohen nga përfitimi i subvencionit sipas përcaktimeve të bëra në pikën 4.1 të kësaj metodologjie, të gjitha shoqëritë e UK-ve, të cilave diferenca të ardhura – kosto direkte e operimit u rezulton me vlerë 0 ose është pozitive.

6. Përjashtohen nga përfitimi i subvencioneve sipas përcaktimit të bërë në pikën 4.2 të kësaj metodologjie, shoqëritë e UK-së, në rastet kur:

- Nuk kanë të firmosur marrëveshjen e performancës midis AKUM-së (ish-AKUK) dhe bashkisë përkatëse;
- Nuk kanë dërguar të dhëna ose të dhënat nuk janë të sakta për vlerësimin e performancës së tyre sipas formatit të kërkuar nga AKUM-ja.

7. Për shpërndarjen e kështit të parë të subvencionit, sipas pikës 4.2, do të merret në analizë rezultati i vitit paraardhës. Për shpërndarjen e kështit të dytë të subvencionit, sipas pikës 4.2, do të merret në analizë, rezultati gjashtëmujor i vitit aktual, ushtrimor.

8. Subvencioni i akorduar nga buxheti i shtetit për shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, do të përdoret sipas përcaktimeve si më poshtë:

8.1 Në rastin kur fondi i subvencionit është dhënë me destinacion mbulimin e KDO-së, ai do të përdoret për blerje klori, si dhe për të paguar faturat e energjisë elektrike.

8.2 Në rastin e përfitimit të subvencionit, për arsye të nxitjes së performancës, shoqëria mund ta përdorë këtë fond, sipas prioriteteve të listuara më poshtë:

a) Për të përballuar efektet financiare në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 18, datë 12.1.2018, "Për subvencionimin e lidhjes së kontratave dhe vendosjen e matësve për kategoritë në nevojë";

b) Për pajisjen me matës prodhimi dhe aparate klorifikimi;

c) Për pajisjen me matës konsumi;

d) Për të përballuar riparimet dhe mirëmbajtjet;

e) Për të përballuar riparimet dhe mirëmbajtjet kapitale të aseteve që zakonisht mbulohen nga vlera e amortizimit, pa tejkaluar vlerën e tij në koston e vitit;

f) Për financimin e projekteve të zbatimit, studimeve të fizibilitetit apo detyrave të projektimit për ujësjellës-kanalizime apo/dhe ITUN;

g) Për blerjen e makinerive, pajisjeve që ndihmojnë sh.a. UK në realizimin e objektivave, sipas biznesit planit të miratuar.

9. AKUM-ja, bazuar në vlerësimin e performancës të sh.a. UK-ve, brenda muajit shtator të çdo viti i propozon ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, metodologjinë dhe skemën që duhet të zbatohet për ndarjen e fondeve, sipas përcaktimeve të bëra në pikat 4.1 dhe 4.2 të kësaj metodologjie.

10. AKUM-ja brenda muajit maj, gusht, nëntor, shkurt, të çdo viti, i dërgon ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën renditjen e shoqërive sipas performancës.

11. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën, e cila bën çeljen e fondit të subvencioneve për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura, ushtron kontrolle periodike për të vlerësuar mënyrën e përdorimit të fondit të akorduar, për çdo ofrues shërbimi apo shoqëri që ka përfituar nga skema e subvencionimit".

URDHËR
Nr. 390, datë 18.9.2018

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS TIP NDËRMJET MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL DHE ORGANIZATAVE TË MENAXHIMIT TË PESHKIMIT PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË PESHKIMIT NË ZONAT BASHKËMENAXHUESE TË PESHKIMIT

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në ligjin nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, si dhe në pikën 7, të

vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 712, datë 31.7.2013, "Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e kontratës tip që do të lidhet ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Organizatave të Menaxhimit të Peshkimit (OMP), për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në zonat bashkëmenaxhuese të peshkimit, sipas modelit bashkëlidhur.

2. Në lidhjen, rast pas rasti të kontratave me Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit, kontrata që do të nënshkruhet, mund të përmbajë edhe kushte të tjera shtesë, që reflektojnë specifikat e zonave të shpallura si zona bashkëmenaxhuese peshkimi.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA) dhe OMP-të.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Niko Peleshi

KONTRATË TIP

PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË PESHKIMIT NDËRMJET MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL DHE ORGANIZATËS SË MENAXHIMIT TË PESHKIMIT

Kjo marrëveshje përbën kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit, regjistruar si OJF, me vendimin nr.____, datë ___.___._____, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor _____, njohur me vendimin e ministrit përgjegjës të fushës nr. ____, datë ___.___. _____.

Marrëveshja është hartuar në përputhje me dispozitat e:

- Ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar;
- Ligji nr. 103/2016, datë 20.10.2016, "Për akuakulturën";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 712, datë 31.7.2013, "Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. ____, datë ___.___._____, "Për shpalljen e _____ *(vendoset kategoria ujore)* _____ *(vendoset emri)* si zonë bashkëmenaxhuese peshkimi";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 301, datë 10.4.2013, "Për përcaktimin e rregullave për grumbullimin, menaxhimin e përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor për strategjinë kombëtare të peshkimit";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 10.4.2013, "Për ngritjen e sistemit të inspektimit për parandalimin, shkurajimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të parregulluar dhe të paraportuar (PPP) dhe krijimin e skemës së certifikimit të zënieve në peshkim";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 8.5.2013, "Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim", të ndryshuar;
- Rregulloja nr. 1, datë 7.3.2014, "Për zbatimin e ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, 'Për peshkimin'".

Neni 1
Palët

Palët në këtë Marrëveshje janë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, këtu e në vijim "Ministria" dhe Organizata e Menaxhimit të Peshkimit _____, person juridik shqiptar, me numër unik të identifikimit të subjektit NIPT: _____, me adresë: _____, përfaqësuar nga kryetari z./znj. _____, shtetas/e shqiptar/e, me numër personal _____, këtu e në vijim "OMP".

Neni 2
Objekti i kontratës

Objekt i kësaj kontrate është dhënia e së drejtës për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit dhe menaxhimit të rezervës peshkore në zonën bashkëmenaxhuese të peshkimit në _____ *(**vendoset kategoria ujore**)* _____ *(**vendoset emri**)* nga ana e OMP-së "_____", në bashkëpunim me MBZHR-në, duke përcaktuar kushtet për kryerjen e aktivitetit, të drejtat dhe detyrimet e Palëve.

Aktivitetet e peshkimit do të rregullohen në bazë të legjislacionit në fuqi për peshkimin dhe akuakulturën, të sipërcituara, si dhe të Planit të Bashkëmenaxhimit të Peshkimit, në _____ *(**vendoset kategoria ujore**)* _____ *(**vendoset emri**)*.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kjo kontratë lidhet për një afat kohor prej 10 (dhjetë) vjetësh, afat i cili fillon nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 4
E drejta e peshkimit

OMP-ja ka të drejtë:

4.1 Të zhvillojë aktivitete të peshkimit artizanal, nëpërmjet përdorimit të metodave, teknikave dhe veglave/mjeteve të peshkimit, në përputhje me legjislacionin e peshkimit.

4.2 Të ushtrojë peshkim artizanal vetëm në ato objekte ujore, të cilat janë shpallur zona të bashkëmenaxhimit të _____ *(**vendoset kategoria ujore**)* _____ *(**vendoset emri**)*.

4.3 Të hartojë Planin e Bashkëmenaxhimit të Peshkimit për _____ *(**vendoset kategoria ujore**)* _____ *(**vendoset emri**)* në bashkëpunim me Ministrinë, për një periudhë jo më të gjatë se 10 vjet.

4.4 Të garantojë që në zonën bashkëmenaxhuese nuk zhvillojnë aktivitet peshkimi persona që nuk janë anëtarë të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit.

4.5 Të marrë përgjegjësitë në bashkëpunim me Ministrinë dhe strukturën shtetërore përgjegjëse për inspektimin/kontrollin në peshkim, për mbrojtjen e resurseve peshkore të liqenit dhe zbatimin e ligjit dhe të rregulloreve të peshkimit, duke ngritur një strukturë përgjegjëse për ruajtjen e ekuilibrit ekologjik dhe shfrytëzimin racional të burimeve peshkore në _____ *(**vendoset kategoria ujore**)* _____ *(**vendoset emri**)*.

Neni 5
Detyrimet e Palëve Kontraktuese

1. OMP-ja depoziton pranë drejtorisë që mbulon peshkimin, listën e peshkatarëve, që janë anëtarë të rregullt të kësaj Organizate, sipas numrit të subjekteve të peshkimit të miratuara së fundmi, që është _____ subjekte, me zonimin përkatës dhe/apo sipas formave të peshkimit (artizanal me mrezha, njica, grepa, me tratë për gjuhcën etj.).

2. Aktiviteti i tyre i peshkimit do të jetë në funksion të planit të bashkëmenaxhimit, i cili do të hartohet nga OMP-ja në bashkëpunim me drejtorinë që mbulon peshkimin dhe do të miratohet nga ministri.

3. OMP-ja duhet të shmangë dhe të mënjanojë mbishfrytëzimin e rezervës peshkore, të zhvillojë vetëm peshkim artizanal dhe joindustrial, të mbrojë e të konservojë biodiversitetin, si dhe ihtiofaunën e _____ *(**vendoset kategoria ujore**)* _____ *(**vendoset emri**)*, nëpërmjet:

- Ndalimit të peshkimit ilegal;
- Ndalimit të peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin e qëllimtë të _____ prej _____ deri më _____ *(këtu vendosen llojet e specieve që nuk mund të gjuhen në periudha të caktuara në përputhje me rregulloren për peshkimin)*;
- Mbrojtjes së zonave të shtimit të peshqve;

- Pastrimit të të gjitha kurtheve artizanale (koceve) të instaluara në breg të kategorive ujore për kapjen e krapit, si dhe parandalimin e instalimit sërish të tyre nga komuniteti përreth;

- Të mos lejojë peshkimin me mjete tërheqëse në formë gabiesh, dragash;

- Ndalimit të peshkimi tregtar industrial;

- këtu vendosen llojet e mjeteve/pajisjeve që nuk mund të përdoren për gjueti sipas specieve në përputhje me rregulloren për peshkimin apo dhe mjetet me karakteristikat përkatëse që lejohet të përdoren për peshkim);

4. OMP-ja pajis anëtarët e saj me lejen përkatëse për ushtrimin e së drejtës së veprimtarisë së peshkimit, sipas modelit të lejes tip të miratuar nga ministri.

5. Në lëshimin e dokumentacionit të mësipërm, Organizata sigurohet që çdo anëtar të jetë i pajisur me dokumentet përkatëse sipas ligjit (certifikatë regjistrimi në QKB, certifikatën e mjetit lundrues dhe mandatpagesën e taksës vjetore për zhvillimin e aktivitetit);

6. Në përzgjedhjen e anëtarëve (në respekt të statutit të saj), OMP-ja bazohet në kritere të barabarta, si dhe në bazë të eksperiencës që kanë subjektet fizike/juridike në këtë sektor. Në vitet në vazhdim ajo bazohet edhe në eksperiencën e subjektit në zbatimin e ligjshmërisë në peshkim gjatë vitit paraardhës, si dhe në shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit, statuti, deklarimi i të dhënave statistikore, etj.;

7. Kujdeset që varkat e peshkimit të jenë në një ngjyrë dhe të kenë vend-bazim të përcaktuar dhe të miratuar nga ana e saj;

8. Ministria dhe OMP-ja bashkëpunojnë në vazhdimësi për të siguruar zbatimin e legjislacionit të peshkimit. Në rast se, struktura shtetërore përgjegjëse për inspektimin/kontrollin në peshkim konstaton shkelje të ligjit nga anëtarët e OMP-së, krahas ndjekjes së procedurës së përcaktuar në ligj, një kopje të procesverbalit ia dërgon OMP-së, e cila bashkëpunon në zbatimin e vendimeve të marra nga struktura shtetërore përgjegjëse për inspektimin/kontrollin ndaj anëtarëve të saj, për shkeljet në peshkim të konstatuara dhe të proceduara;

9. Ministria, nëpërmjet strukturave të saj, merr masa brenda kompetencave ligjore, për të siguruar respektimin e së drejtës së ushtrimit të aktivitetit, që i është dhënë subjektit të mësipërm, bazuar në këtë kontratë, të parashikuar në nenet 55, 56, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, "Për *peshkimin", të ndryshuar*;

10. Ministria dhe OMP-ja, brenda një viti nga firmosja e kësaj kontrate, duhet të hartojnë Planin e bashkëmenaxhimit të peshkimit të zonës së dhënë për shfrytëzim dhe menaxhim sipas përcaktimeve të nenit 55, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, "*Për peshkimin", të ndryshuar*;

11. Ministria, nëpërmjet drejtorisë që mbulon peshkimin, gëzon të drejtën ligjore të kontrollojë në çdo kohë respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e OMP-së, veçanërisht për:

- Raportim të rregullt, në mënyrë periodike dhe korrekte, te strukturat përkatëse në drejtorinë që mbulon peshkimin, brenda 10-ditëshit të parë të çdo muaji, të të dhënave mbi sasinë e peshkimi të çdo lloj peshku për muajin paraardhës, si dhe brenda datës 15 janar të çdo viti për të dhënat e përgjithshme për vitin paraardhës.

- Respektim të legjislacionit, veçanërisht, të numrit të peshkatarëve sipas aktivitetit të miratuar, në zonat e përcaktuara/ndaluara, specieve të lejuara/ndaluara, të veglave dhe pajisjeve të peshkimit të lejuara/ndaluara, afatet kohore ligjore të peshkimit, periudhave të ndalimit të peshkimit, dimensionet e veglave të peshkimit dhe peshkut të zënë, të procedurave të trajtimit të produktit deri në treg.

12. Shkeljet për rastet e lartpërmendura, duhet të konstatohen në një akt të veçantë, të mbajtur midis palëve ose përfaqësuesve të tyre, sipas dispozitave ligjore përkatëse, i cili nënshkruhet në prani të tyre;

13. Për çdo shkelje të konstatuar, në zbatim të pikave të mësipërme të kontratës, zbatohen dispozitat ligjore në fushën e peshkimit dhe akuakulturës, me masën e gjobës së parashikuar në ligj deri në prishjen e kontratës;

14. OMP-ja nuk mund të transferojë të drejtën e siguruar nga kjo kontratë për përdorimin e objektit te të tretët;

15. OMP-ja nuk ka të drejtë të lidhë nënkontraktime me subjekte të tjera;

16. OMP-ja ka për detyrë të lejojë dhe të shoqërojë përfaqësuesit e strukturës shtetërore përgjegjëse për inspektimin/kontrollin dhe monitoruesit e peshkimit në ministri, që të ushtrojnë kontrolle për zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuara në kontratë, si dhe të kryejë detyrat funksionale në bazë të legjislacionit në fuqi;

17. OMP-ja detyrohet të zbatojë çdo dispozitë të re ligjore/nënligjore ose ndryshim të dispozitave ligjore ekzistuese në fushën e peshkimit dhe akuakulturës, si dhe të statusit mjedisor të zonës;

18. Përdorimi i infrastrukturave të lidhura me veprimtarinë e peshkimit të kësaj organizate, realizohet sipas kritereve dhe kushteve që vijojnë:

- të mos ndryshohet destinacioni dhe qëllimi;
- të garantohet përdorimi i infrastrukturës së peshkimit nga ana e shtetit në rastet e masave të jashtëzakonshme;
- të ruhet dhe të garantohet interesi publik;
- të ruhet dhe të rritet vlera ekonomike.

Neni 6

Modifikimi i kontratës

Modifikime në këtë kontratë nuk lejohen. Në raste të veçanta çdo modifikim lejohet vetëm pas miratimit me shkrim nga të dyja palët dhe përpilimit të aneks-kontratës përkatëse shtesë.

Kjo kontratë mund të rishikohet nga ana e ministrisë dhe OMP-së, në rast se zona e bashkëmenaxhimit e miratuar për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit do të jetë objekt i zbatimit të projekteve apo i një statusi më të lartë mbrojtjeje mjedisore apo menaxhuese të miratuara nga shteti shqiptar.

Neni 7

Përfundimi i kontratës

1. Kjo kontratë përfundon në momentin e përfundimit të afatit të saj të përcaktuar në kontratë.

2. Kjo kontratë përfundon para afatit të përcaktuar në nenin 3 të saj, kur OMP-ja:

2.1 Pushon së ekzistuari;

2.2 Nga veprimtaria e anëtarëve të saj cenohet rëndë mjedisi dhe provohet se OMP-ja nuk ka marrë masa ndaj anëtarëve të saj, sipas detyrimeve të përcaktuara në statut;

2.3 Brenda një viti nga çasti i nënshkrimit të kësaj kontrate, nuk harton dhe fillon zbatimin e Planit të Bashkëmenaxhimit të Peshkimit në _____ ***(vendoset kategoria ujore)*** _____ ***(vendoset emri)***;

2.4 Nuk zbaton parashikimet ligjore dhe/ose statutore dhe bëhet shkak për moszbatimin e detyrimeve të parashikuara në Planin e Bashkëmenaxhimit të Peshkimit në _____ ***(vendoset kategoria ujore)*** _____ ***(vendoset emri)***;

2.5 Në qoftë se pas nënshkrimit të kontratës, vërtetohet me fakte, se e drejta e zhvillimit të aktivitetit është dhënë në bazën e të dhënave jo të sakta dhe fakteve të pavërteta;

2.6 Nuk plotëson detyrimin për plotësimin dhe komunikimin e deklarimeve statistikore deri në datën 10 të çdo muaji për muajin paraardhës;

2.7 Nuk përmbush detyrimet që ndërmerr, si riparimi i infrastrukturave ekzistuese, ndërtimi i infrastrukturave të reja, si dhe pagesat vjetore;

2.8 Nuk njihet më, në vijim të tërheqjes së njohjes nga ministri, në përputhje me nenin 62, pika 3, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Të gjitha mosmarrëveshjet e lindura nga ose në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet palëve.

2. Pala që gjykon se ekziston një mosmarrëveshje, njofton palën tjetër, duke bërë një përshkrim të plotë të çështjeve që kërkojnë zgjidhje.

3. Personat e autorizuar duhet të bëjnë përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, mbi parimin e ruajtjes së vazhdimësisë së punës.

4. Procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve përcaktohen dhe mbikëqyren nga ministria.

5. Për të gjitha mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, palët do t'i drejtohen gjykatës administrative kompetente.

Neni 9
Të ndryshme

1. Kjo kontratë rregullohet dhe do të interpretohet në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

2. Çdo kusht i kësaj marrëveshjeje që bie në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit shqiptar në fuqi, konsiderohet i pavlefshëm. Në rast të mospërputhjeve ndërmjet parashikimeve të marrëveshjes dhe parashikimeve ligjore në fuqi, do të konsiderohet se mbizotërojnë parashikimet e ligjit dhe/ose akteve të tjera ligjore, të cilat janë drejtpërdrejt të zbatueshme në këtë kontratë.

3. Kjo kontratë nënshkruhet në 4 kopje origjinale, nga të cilat tri depozitohen në ministri dhe një tek OMP-ja.

4. Kontrata hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.

Sot, në Tiranë, më ____.____._____.

PALËT KONTRAKTUESE:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Organizata e Menaxhimit të Peshkimit "_____"
Ministri	Kryetari i OMP-së "_____"

URDHËR
Nr. 660, datë 20.9.2018

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES MBI PRAKTIKAT E RUAJTJES DHE TË SHPËRNDARJES SË MIRË TË BARNAVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 30, pika 2, të ligjit nr. 105/2014, "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Mbi praktikat e ruajtjes dhe të shpërndarjes së mirë të barnave", sipas tekstit bashkëngjitur këtij urdhri.

2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore për zbatimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi më 1 janar 2019 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

RREGULLORE
MBI PRAKTIKAT E RUAJTJES DHE TË SHPËRNDARJES SË MIRË TË BARNAVE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i praktikave të ruajtjes dhe shpërndarjes së mirë të barnave, duke përshkruar masat e veçanta, që konsiderohen të përshtatshme për ruajtjen dhe transportimin e barnave.

2. Kjo rregullore përcakton mënyrat e ruajtjes dhe të shpërndarjes së barnave nëpërmjet përcaktimit të kushteve, të cilave duhet t'iu përmbahet çdo tregtues me shumicë në Republikën e Shqipërisë.

3. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore është institucioni përgjegjës për kontrollin e çdo veprimtarie në fushën farmaceutike dhe zbatimin e kësaj rregulloreje.

Neni 2
Përkufizime

1. "Akull i thatë" është dyoksid karboni solid, që përdoret për të mbajtur barnat në kushte të ftohta.

2. "Bar i falsifikuar" është bari me një prezantim të rremë:

a) Të identitetit të tij, përfshirë paketimin dhe etiketimin, emrin ose përbërjen e tij, referuar ndonjë prej përbërësve, lëndët ndihmëse dhe përqendrimin e këtyre përbërësve;

b) Të burimit të tij, përfshirë prodhuesin dhe vendin e tij të prodhimit, vendin e origjinës ose mbajtësin e autorizimit të tregtimit;

c) Të historikut të tij, përfshirë regjistrimet dhe dokumentacionin mbi shpërndarjen.

3. "CAPA" *(Correcting Activities and Preventing Activities)* veprimtari korrigjuese dhe parandaluese, janë përmirësimet e procedurave të një tregtuesi me shumicë, me qëllim eliminimin e situatave të padëshiruara ose që ndodhin jo në përputhje me rregullat, duke cenuar në këtë mënyrë cilësinë e barit.

4. "Datë skadence" është data e shkruar në etiketën e paketimit individual të barit dhe që përfshin kohën gjatë së cilës bari qëndron sipas specifkimeve të nxjerra nga studimet e stabilitetit nëse ruhet në mënyrën e duhur.

5. "Gabim mjekësor" është çdo ngjarje e parandalueshme, që mund të shkaktojë ose të çojë në një përdorim të papërshtatshëm të mjekimit apo dëmtim të pacientit, gjatë kohës që mjekimi është nën kontrollin e profesionistit të shëndetësisë, pacientit ose konsumatorit.

6. "Harta e temperaturave" është procesi i vlerësimit periodik të njëtrajtshmërisë së temperaturave përgjatë ambientit të ruajtjes së barnave. Gjatë këtij procesi, monitorët e temperaturës vendosen në zonat që kanë më shumë gjasa të tregojnë fluktuacione.

7. "Kontaminim" është kontakti i padëshiruar i lëndëve të para, produktit të ndërmjetëm ose barit me papastërti kimike, mikrobiologjike apo të çfarëdolloj natyre të jashtme, gjatë procesit të dërgimit, prodhimit, marrjes së mostrave, paketimit ose ripaketimit, ruajtjes dhe transportimit.

8. "Kontaminim i kryqëzuar" është kontaminimi i lëndëve të para, produktit të ndërmjetëm ose barit me një tjetër produkt fillestar, të mesëm ose përfundimtar farmaceutik gjatë prodhimit, ruajtjes dhe transportimit.

9. "Kualifikim" është veprimtaria e të vërtetuarit se çdo pajisje funksionon në mënyrë korrekte dhe jep rezultatet e kërkuara.

10. "Menaxhimi i riskut për cilësinë" është një proces sistematik për vlerësimin, kontrollin, komunikimin dhe rishikimin e riskut ndaj cilësisë së barit gjatë gjithë ciklit jetësor të tij.

11. "Pajisje frigoriferike": termi "frigoriferik" ose "pajisje frigoriferike" është çdo pajisje, qëllimi i së cilës është të ulë temperaturën e produktit dhe të ajrit dhe/ose të kontrollojë lagështirën.

12. "Paketim parësor" është çdo formë e paketimit në kontakt të drejtpërdrejtë me barin.

13. "Paketim i jashtëm" është paketimi, në të cilin vendoset paketimi parësor.

14. "Pastërti" është heqje e pluhurit nga një sipërfaqe me ujë ose detergjent të përshtatshëm.

15. "Sigurimi i cilësisë" përfshin të gjitha veprimtaritë, të kryera në mënyrë individuale ose kolektive, që influencojnë cilësinë e barit dhe plotësojnë kërkesat e cilësisë së barnave për përdorimin e tyre të përshtatshëm.

16. "Sistemi i cilësisë" përfshin strukturën organizative, procedurat, proceset dhe burimet, si dhe aktivitetet e nevojshme, për të siguruar se bari i dorëzuar ruan cilësinë dhe integritetin e tij dhe mbetet brenda zinxhirit zyrtar të furnizimit gjatë ruajtjes dhe/ose transportit.

17. "Temperaturë ruajtjeje" është temperatura që shkruhet në etiketën e barit. Kjo duhet të jetë temperatura që duhet të tregojë termometri i ambientit ku ruhet bari dhe i ambienteve të shpërndarjes (makinat frigoriferike ose mënyrat e tjera të transportit).

18. "Transport" është procesi i lëvizjes së një bari nga një vend në tjetrin.

19. "Tërheqja nga tregu" është procesi i tërheqjes së një bari nga zinxhiri farmaceutik i shpërndarjes për shkak të defekteve të barit, të efekteve të padëshiruara serioze të barnave dhe/ose raportimeve, se bari është ose mund të jetë i falsifikuar. "Tërheqja nga tregu" mund të

iniciohet nga prodhuesi, tregtuesi me shumicë ose agjencia përgjegjëse.

20. "Validim" është veprimi i të vërtetuarit se çdo procedurë, proces, pajisje, material, aktivitet ose sistem, jep rezultatet e kërkuara.

21. "Zona karantinë" është ajo pjesë e ambientit të ruajtjes që është e ndarë nga zonat e tjera dhe përdoret kryesisht për ruajtjen e barnave, të cilat duhen mbajtur të izoluara për shkak se dyshohet të jenë burim kontaminimi ose, sepse nuk është marrë ende një vendim lidhur me procedurat që do të ndiqen për to (si për shembull: barnat e dëmtuara, të skaduara, të kthyera).

22. "Sigurimi i cilësisë" është tërësia e masave të marra, me qëllim sigurimin e cilësisë së kërkuar të barnat për përdorimin e tyre. Pjesë e sigurimit të cilësisë janë: praktikat e mira të shpërndarjes (*GDP Good Distribution Practices*), praktikat e mira të ruajtjes (*Good Storage Practices GSP*), praktikat e mira të prodhimit (*GMP Good Manufacturing Practices*), praktikat e mira të farmacisë (*Good pharmacy practice GPP*).

23. "Sistemi i cilësisë" është një infrastrukturë e përshtatshme, që përfshin strukturën organizative, procedurat, proceset, burimet dhe veprimet sistematike të nevojshme, për të siguruar që një produkt (ose shërbim) dhe dokumentacioni përkatës, të plotësojnë kërkesat e dhëna për cilësinë.

KREU II
PRAKTIKAT E RUAJTJES SË MIRË TË BARNAVE

Neni 3
Personeli

1. Të gjitha subjektet tregtues me shumicë duhet të kenë një strukturë organizative të personelit të përshtatshëm e të kualifikuar, për të arritur objektivat e sigurimit të cilësisë.

2. I gjithë personeli duhet të jetë i mirinformuar nëpërmjet rregullores për higjienën e ambientit, e cila është e afishuar në një vend të dukshëm mbi higjienën e ambientit dhe të respektojë nivelet e larta të higjienës personale.

3. Të gjitha subjektet tregtues me shumicë duhet të caktojnë një person përgjegjës për sistemin e menaxhimit të cilësisë me profesion "farmacist", në strukturën organizative të personelit.

Neni 4
Ruajtja në magazina, makinat transportuese dhe ambientet e shpërndarjes

1. Barnat duhet të ruhen në vende, të cilat plotësojnë kushtet e paracaktuara nga prodhuesit. Kur këto të fundit nuk janë plotësuar, atëherë ndikohet seriozisht cilësia dhe siguria e barnave dhe rrjedhimisht edhe shëndeti i pacientit.

2. Zonat e ruajtjes duhet të jenë të pastra nga mbeturinat e akumuluara dhe parazitët. Çdo subjekt duhet të përcaktojë vetë frekuencën e pastrimit dhe metodat, që do të përdoren për të pastruar mjedisin dhe zonat e magazinimit, të cilat i publikon në një rregullore të posaçme organizimi.

Neni 5
Magazinat dhe zonat e tjera të ruajtjes

1. Zonat e ruajtjes duhet të kenë kapacitet të mjaftueshëm për të lejuar ruajtjen e rregullt të formave të ndryshme farmaceutike të barnave.

2. Zonat e magazinimit duhet të jenë të përshtatshme për të siguruar kushte të mira të ruajtjes. Në veçanti, ato duhet të jenë të pastra, brenda kufijve të temperaturës dhe të lagështirës. Kushtet e ruajtjes duhet të sigurohen, kontrollohen, monitorohen sipas specifikimeve në etiketën e barit. Barnat nuk duhet të jenë në kontakt të drejtpërdrejtë me dyshemenë dhe muret e të kenë hapësirë të përshtatshme për të lejuar pastrimin dhe inspektimin.

3. Duhet të kryhet mbikëqyrja periodike e luhatjeve të temperaturës në magazinë, në mënyrë që të implementohet një vlerë konstante e saj në të gjithë hapësirën e magazinës.

4. Kur zona e karantinës është brenda zonave të ruajtjes, ajo duhet të specifikohet me shenjën dalluese dhe në të mund të hyjnë vetëm personat e autorizuar. Çdo ambient për zëvendësimin fizik të karantinës duhet të ofrojë siguri ekuivalente. Masat e sigurisë duhet të përshkruhen qartë në një manual të posaçëm të miratuar nga Agjencia, të publikohen në vende të dukshme dhe t'i shpërndahen personelit të autorizuar, të cilët duhet të firmosin për njohjen me dokumentin dhe pranimin e tij.

5. Materialet radioaktive, lëndët narkotike, lëndët e tjera të rrezikshme, barna të rrezikshme, si dhe substanca që paraqesin rreziqe të veçanta të abuzimit, zjarrit ose shpërthimit, p.sh.: lëngjet e djegshme dhe gazet nën presion etj., duhet të ruhen secila në zona të veçanta me siguri të përshtatshme. Në qoftë se një karantinë brenda zonës së ruajtjes ndryshon vendndodhje për arsye zmadhimi ose zvogëlimi, ajo duhet të ofrojë siguri ekuivalente. Në vende të dukshme të ambientit duhet të vendosen shenjat ndërkombëtare të nevojshme.

6. Barnat duhet të trajtohen dhe të ruhen në një mënyrë të tillë që të parandalohet kontaminimi, përzierja dhe kontaminimi i kryqëzuar.

7. Barnat duhet të ruhen në kushte që të sigurojnë garantimin e cilësisë së tyre dhe duhet të qarkullojnë sipas parimit: *Bari që ka skadencë më të afërt del i pari (FEFO) dhe/ose bari i parë që ka hyrë në ambientet e ruajtjes është i pari që del jashtë (FIFO).*

8. Lëndët narkotike dhe psikotrope duhet të ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë për barnat narkotike dhe psikotrope.

9. Zonat e magazinimit duhet të kenë ndriçim të përshtatshëm për të mundësuar kryerjen e të gjitha procedurave me saktësi dhe në mënyrë të sigurt dhe barnat nuk duhet të jenë të ekspozuara drejtpërsëdrejti ndaj dritës së diellit.

10. Disa barna mund të jenë fotosensitive dhe do të dëmtohen nëse ekspozohen ndaj kësaj drite.

Për të mbrojtur këto barna nga drita e diellit duhet të merren këto masa:

a) Të mbulojnë dritaret ose të përdorin perde, nëse janë të ekspozuar direkt në dritë;

b) T'i mbajnë këto barna të paketuara në karton;

c) Të mos i ruajnë ose paketojnë në ambiente, ku bie direkt drita e diellit.



Neni 6

Kushtet e magazinimit

1. Kushtet e ruajtjes së barnave duhet të jenë në përputhje me etiketimin, i cili bazohet në rezultatet e studimeve të stabilitetit.

2. Raftet e ruajtjes duhet të kenë mes tyre një korridor kalimi, i cili duhet të mundësojë lëvizjen e lirë të personelit, si dhe vendosjen e kutive në rafte.

3. Barnat e lëngshme duhen vendosur në raftet e poshtme.

4. Subjekti duhet të jetë i pajisur me mjete zjarrfikëse, sipas përcaktimeve të bëra nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga zjarri, të vendosura në vend të dukshëm dhe personeli duhet të jetë i mirinformuar mbi përdorimin e tyre.

Neni 7

Monitorimi i kushteve të ruajtjes

7.1 Stabilizimi i temperaturës

a) Vlerat e temperaturës mund të kontrollohen, duke përdorur një numër të përshtatshëm termometrash ose mjete të tjera të monitorimit të temperaturës.

b) Ata duhen vendosur në seksione të ndara dhe duhet të regjistrojnë maksimumin dhe minimumin e temperaturës gjatë një periudhe 24-orëshe.

c) Monitorimi i temperaturës në zonat e ruajtjes, që janë tashmë në përdorim duhet të kryhet në periudha kur dihet që mund të ketë temperatura të jashtme ekstreme. Intervali i procedurës së fundit duhet të jetë në periudha prej jo më pak se 3-orëshe, kur temperatura e jashtme është më shumë se 25˚dhe më pak se 15˚.

ç) Monitorimi i temperaturës në zonat e ruajtjes së barnave të zinxhirit të ftohtë (2–8˚C) do të kryhet në intervale prej jo më shumë se 15 minutash,

d) Ruajtja korrekte e barnave duhet të sigurohet që prej fazës vitale të prodhimit, transportit, stokut dhe deri në fazën e përdorimit final. Barnat nuk duhet të jenë jashtë paketimit parësor dhe atij të jashtëm, kjo është shumë e rëndësishme për ruajtjen e barit, për të identifikuar barin (emrin, lotin, datën e prodhimit, skadencës) e për të parandaluar gabimet mjekësore. Këshillohet të mos hidhet fleta përshkruese që qëndron në kutinë e paketimit dytësor.

dh) Temperaturat e ruajtjes duhet të jenë subjekt monitorimi.

e) Pajisjet e përdorura për monitorim duhet të kontrollohen dhe rezultatet e këtyre monitorimeve duhet të ruhen për 1 vit pas përfundimit të afatit të përdorimit të barnave.

7.2 Validimi i pajisjeve monitoruese të temperaturës dhe lagështirës

Pajisjet monitoruese të temperaturës dhe lagështirës, për të matur temperaturën dhe lagështirën relative të barit, duhet të jenë të përshtatshme për qëllimin që po përdoren. Ato duhet të validohen. Validimi është një proces që siguron përdoruesin e pajisjes monitoruese që pajisja është testuar para përdorimit dhe në mënyrë periodike nga prodhuesi ose përdoruesi, në mënyrë që të vlerësohet saktësia në matje dhe në kohën e pajisjes.

Dokumenti që vërteton validimin, t'i paraqitet sa herë që është e nevojshme institucioneve inspektuese. Monitoruesit e përdorur në prodhim, ruajtje dhe transportin e barnave duhet të jenë të kualifikuar paraprakisht nga përdoruesit e tyre, në mënyrë që të sigurohen se janë mbajtur dhe përdorur në kushtet e duhura të punës.

Saktësia në matje. Për pajisjet monitoruese të temperaturës dhe lagështirës, saktësia në matje i referohet faktit se sa pranë rezultatit real është rezultati që tregon pajisja. Në praktikë kjo bëhet duke përdorur pajisje që janë kalibruar kundrejt një standardi ndërkombëtar të njohur në vendin tonë.

Matja e reagimit të pajisjes. Çdo pajisje monitoruese ka një nivel reagimi nga ndryshime të mundshme të temperaturës ose të lagështirës. Mund të matet si koha që i duhet pajisjes për të lexuar një vlerë të caktuar pas një ndryshimi të menjëhershëm të temperaturës ose lagështirës në mjedisin ku po bëhet matja. Kalibrimi i pajisjeve monitoruese të temperaturës dhe lagështirës të përcillet ose të konfirmohet nga institucioni përgjegjës.

Saktësia në kohë. Zakonisht, saktësia në kohë shprehet si përqindja e kohëzgjatjes totale të periudhës së regjistrimit të matjes, zakonisht 0.05% është një vlerë e pranueshme në praktikën farmaceutike.

7.3 Krijimi i hartave të temperaturës në zonat e ruajtjes

Kërkesat për krijimin e hartave të temperaturës

7.3.1 Të gjitha zonat e ruajtjes me temperaturë të kontrolluar duhet të kenë të stabilizuara harta të temperaturës (ndarje sipas temperaturës që ka secili ambient i zonave të ruajtjes). Pa u stabilizuar ky sistem është e pasigurt të ruhen në to barnat termolabile. Për t'u realizuar krijimi i hartave të temperaturës këto procedura, duhet të:

a) Tregojnë vlerat e temperaturës në të gjithë zonën e ruajtjes, kur kjo e fundit është bosh dhe kur në të ndodhen barnat që do të ruhen;

b) Përcaktojnë zonat që nuk do të përdoren për ruajtjen e barnave të ndjeshme nga temperatura (si për shembull: zonat pranë burimeve të nxehtësisë, rrymave të ftohta të ajrit etj.);

c) Demonstrojnë se sa kohë duhet për temperaturën që të kalojë limitet e parashikuara, në momentet që ka shkarkesë elektrike ose probleme të tjera me elektricitetin.

Duhet të kryhen periodikisht verifikime që të shihet nëse këto harta të temperaturës vazhdojnë të jenë kompliante. Vlerat e temperaturës në këto zona duhet të monitorohen dhe regjistrohen në periudha kohore të caktuara. Ato duhet të jenë lehtësisht të printueshme në çdo moment që kërkohet.

7.3.2 Kushtet frigoriferike dhe ruajtja e barnave nga temperatura:

Në bazë të temperaturës së ruajtjes së barnave, kemi këto kategori:

a) Barna që nuk ruhen në mbi 30°C.

b) Barna që nuk ruhen në mbi 25°C.

c) Barnat që ruhen nga 2–8°C, të cilat vendosen në frigorifer.

ç) Barnat që ruhen në temperaturë më pak 0°C që vendosen në akull, "Frigorifer *Freezer*".

7.3.2.1 Barnat frigoriferike (ato që kërkojnë me patjetër ruajtje në temperatura 2–8°C) duhet të ruhen në një frigorifer të posaçëm për ruajtjen e barnave ose dhomë frigoriferike, të sigurt, e cila përdoret vetëm për barna.

a) Frigoriferi duhet të mbyllet ose të mbahet në një ambient të mbyllur të barnave. Ky ambient duhet të jetë i aksesueshëm vetëm nga stafi përgjegjës për ruajtjen.

b) Kur barnat që kërkojnë ftohje mbërrijnë në ambientin e ruajtjes, ato duhet të identifikohen menjëherë dhe vendosen në frigoriferin e barnave.

c) Frigoriferët duhet të mbahen gjithmonë në gjendje pune. Fiket vetëm kur riparohet dhe kur nuk ka barna në të.

ç) Të gjithë frigoriferët ku ruhen barnat duhet të kontrollohen të paktën një herë në vit, lidhur me ndonjë defekt të mundshëm.

d) Duhet të ketë një ruajtje në mënyrë të rregullt të barnave, në rafte, shmangie të mbingarkesës dhe hapësirë midis kutive dhe shisheve. Mos mbani sasi të mëdha barnash në frigorifer, pasi kjo mund të çojë në rrjedhjen e pamjaftueshme të ajrit dhe ngrirjen e mundshme. Barnat nuk duhet të prekin pjatën ftohëse në pjesën e prapme të frigoriferit.

dh) Të gjithë frigoriferët duhet të pastrohen në mënyrë periodike dhe të ruhen të dhënat e mbajtura.

e) Frigoriferi i barnave duhet të monitorohet duke përdorur një termometër që mat të dyja masat minimale dhe temperaturat maksimale.

7.4 Monitorimi i temperaturës ditore frigoriferike:

a) Temperatura e frigoriferit duhet të kontrollohet dhe të regjistrohet çdo ditë çdo 15 minuta. Rekomandohet të regjistrohen të gjitha temperaturat minimale, maksimale dhe aktuale.

b) Temperatura e frigoriferit duhet të mbahet në mes të intervalit prej +2°C dhe +8°C.

Neni 8

Dokumentacioni

1. Dokumentacioni duhet të jetë i disponueshme për të dokumentuar të gjitha aktivitetet në ambientet e ruajtjes përfshirë dhe menaxhimin e stokut të barnave të skaduara. Këto duhet të përshkruajnë në mënyrë të përshtatshme procedurat standarde të ruajtjes dhe të përcaktojnë rrugën e barnave dhe informacion në lidhje me organizimin e procedurave në rastin kur kërkohet tërheqje e barit.

2. Për çdo dërgesë duhen mbajtur të dhëna, që duhet të përfshijnë përshkrimet e mallrave, sasinë, furnizuesit, numrat e serisë dhe datën e skadencës.

3. Faturat tatimore e barnave duhet të ruhen sipas një sistemi të mirëpërcaktuar (p.sh., sipas numrit të serisë etj.).

Neni 9

Etiketimi dhe paketimi

1. Të gjitha barnat duhet të kenë një paketim, që nuk ndikon negativisht në cilësinë e tyre dhe që ofron një mbrojtje të përshtatshme nga faktorët e jashtëm.

2. Të gjitha paketimet duhet të jenë të etiketuara qartë me të paktën emrin e barit, serinë, datën e skadencës ose të rivlerësimit, kushtet specifike të ruajtjes dhe nëse janë të aplikueshme, referenca nga farmakopeja.

3. Monitorimi i mirëmbajtjes së cilësisë së barnave duhet të bëhet duke pasur parasysh indikatorë të ndryshëm si:

a) Paketim i thyer apo i dëmtuar;

b) Etiketë e paplotë, e palexueshme ose që mungon në paketim;

c) Diskolorim, sedimentim, thyerje e tapës së shishes, krisje të ampulës ose të shishes, në rast të formave farmaceutike të lëngëta;

ç) Diskolorim, tableta të thërrmuara, numër jo i plotë i tabletave në blister, tabletat bëhen si të ngjitshme (veçanërisht ato të veshura me film), erë e pazakontë në rast të formave farmaceutike tableta;

d) Lëngu nuk kthehet në precipitat direkt pasi tundet (format farmaceutike të injektueshme);

dh) Diskolorim, ngjitje apo thyeje në rast të formave farmaceutike kapsula.

Neni 10
Marrja në dorëzim e barnave

1. Me marrjen në dorëzim të barnave duhet të kontrollohet përputhshmëria fizike mes barit dhe faturës, përfshirë këtu sasinë, numrin e serisë dhe datën e skadencës.

2. Çdo kontejner/paketim duhet të kontrollohet me kujdes për kontaminim të mundshëm, ngatërrim ose dëmtim. Çdo paketim i dyshimtë dhe nëse është e nevojshme, e gjithë ngarkesa duhet të vendosen në karantinë për hetim të mëtejshëm.

3. Barnat duhet të qëndrojnë në karantinë deri në një urdhër të dytë që autorizon nxjerrjen për tregtim ose tërheqjen nga tregu.

4. Duhet të merren masa për t'u siguruar që barnat e tërhequra nga tregu të mos përdoren. Ato duhet të ruhen veçmas nga barnat e tjera, ndërsa pritet që të shkatërrohen ose që të kthehen te tregtuesi me shumicë ose prodhuesi.

Neni 11
Mallrat e kthyera

1. Barnat e kthyera, duke përfshirë edhe ato që tërhiqen nga tregu, duhet të trajtohen në përputhje me procedurat e caktuara dhe të jenë të dokumentuara.

Të gjitha barnat e kthyera duhet të vendosen në karantinë dhe mund të rikthehen në treg vetëm pas rikontrollit të cilësisë. Kthimi bëhet me aprovim me shkrim nga personi përgjegjës i tregtuesit me shumicë për kontrollin e cilësisë.

2. Të gjitha barnat e rikthyera duhet të identifikohen në dokumentacionin e stokut.

Neni 12
Shpërndarja dhe transporti

1. Barnat duhet të transportohen në mënyrë të tillë që të mos dëmtohet integriteti i tyre dhe të respektohen kushtet e ruajtjes.

2. Kujdes i veçantë duhet të tregohet në rastin kur përdoret akull i thatë në zinxhirin e ftohtë, në këtë rast duhet të respektohen masat e sigurisë në mënyrë që barnat të mos bien në kontakt të drejtpërdrejt me akullin e thatë, pasi kjo mund të ndikojë negativisht në cilësinë e barit, si p.sh., mund të shkaktojë ngrirjen e tij.

3. Kur është e nevojshme rekomandohet të përdoret pajisje monitoruese për kushtet e ruajtjes, si p.sh., për temperaturën, gjatë transportit. Të dhënat e monitorimit duhet të jenë në dispozicion për shqyrtim.

4. Procedurat e shpërndarjes dhe transportit duhet të përcaktohen dhe të dokumentohen duke marrë në konsideratë natyrën e barnave në fjalë dhe masat e veçanta që mund të jenë të nevojshme.

5. Kontejneri i jashtëm duhet të ofrojë mbrojtje të përshtatshme nga ndikimet e agjentëve të jashtëm.

6. Duhet të mbahen të dhënat për shpërndarjen, duke përfshirë të paktën:

a) Datën e dërgimit;

b) Emrin dhe adresën e klientit;

c) Përshkrimin e barit, p.sh.: emri, seria dhe sasia.

Neni 13
Kushtet e ruajtjes në farmaci dhe agjenci farmaceutike

1. Farmaci është njësia shëndetësore-tregtare ku kryhet furnizimi, ruajtja, përgatitja, ambalazhimi, paketimi, kontrolli, dhënia e barit dhe informacionit për përdorimin e tij, si dhe shërbime të tjera të kujdesit shëndetësor e cila ushtron veprimtarinë vetëm në prani të drejtuesit teknik ose të farmacistit të punësuar për të arritur objektivat e sigurimit të cilësisë.

2. Në zonat rurale, vetëm kur nuk ka farmaci, miratohet hapja e agjencive farmaceutike me drejtues teknik ndihmësfarmacist, e cila tregton barna me pakicë, në bazë të listës së miratuar nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

3. I gjithë personeli në farmaci apo në agjencinë farmaceutike duhet të jetë i mir-informuar nëpërmjet rregullores për higjienën e ambientit dhe të respektojë nivelet e larta të higjienës personale.

4. Barnat duhet të ruhen në vende, të cilat plotësojnë kushtet e paracaktuara nga prodhuesit. Kur këto të fundit nuk janë plotësuar, atëherë ndikohet seriozisht cilësia dhe siguria e barnave dhe rrjedhimisht edhe shëndeti i pacientit.

5. Ambienti i farmacisë dhe agjencisë farmaceutike duhet të ketë kapacitet të mjaftueshëm për të lejuar ruajtjen e rregullt të formave të ndryshme farmaceutike të barnave, brenda kufijve të temperaturës dhe lagështirës sipas shtojcës 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje. Kushtet e ruajtjes duhet të sigurohen, kontrollohen, monitorohen sipas specifikimeve në etiketën e barit. Barnat nuk duhet të jenë në kontakt të drejtpërdrejtë me dyshemenë dhe muret, gjithashtu, duhet të kenë hapësirë të përshtatshme për të lejuar pastrimin dhe inspektimin.

Barnat nuk duhet të jenë të ekspozuara drejtpërdrejt ndaj dritës se diellit. Vlerat e lagështirës dhe të temperaturës së ambientit mund të kontrollohen duke përdorur termometra dhe matës lagështire të përshtatshëm muri, ose mjete të tjera të monitorimit.

6. Barnat frigoriferike (ato që kërkojnë me patjetër ruajtje në temperatura 2–8°C) duhet të ruhen në një frigorifer të posaçëm i cili përdoret vetëm për barna. Frigoriferi duhet të mbahet gjithmonë në gjendje pune. Fiket vetëm kur riparohet dhe kur nuk ka barna në të. Të gjithë frigoriferët ku ruhen barnat duhet të kontrollohen të paktën një herë në vit, lidhur me ndonjë defekt të mundshëm.

7. Barnave të cilave u ka mbaruar afati i përdorimit duhet të evidentohen dhe të ruhen në ambient të veçantë nga barnat e tjera deri në asgjësimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi.

8. Farmacia duhet të ketë një sipërfaqe mbi 35 m², kurse agjencitë farmaceutike mbi 15 m², e cila evidentohet me planimetrinë e ambientit.

9. Farmacia e cila realizon përgatitje galenike duhet të ketë pajisjet dhe mjetet e nevojshme për realizimin e tyre në një mjedis të veçantë pune. Këto përgatesa kryhen bazuar në formularin farmaceutik dhe/ose recetës së mjekut. Ato përgatiten me lëndë të para të kontrolluara dhe të shoqëruara me certifikatën e analizës.

10. Farmacitë të cilat janë të autorizuara për të tregtuar barnat narkotike dhe helmet duhet t'i ruajnë ato në kasafortë me kyç të fiksuar në mur.

KREU III
PRAKTIKAT E SHPËRNDARJES SË MIRË TË BARNAVE

Neni 14
Shpërndarja

1. Të gjitha palët e përfshira në shpërndarjen e barnave janë të ngarkuara me përgjegjësinë e sigurimit të cilësisë së barnave dhe integritetit të zinxhirit të shpërndarjes, i cili duhet të ruhet gjatë gjithë procesit të shpërndarjes, duke filluar nga prodhuesi deri te subjektet përgjegjëse për shpërndarjen dhe momentin final të dorëzimit të barit te pacienti.

2. Tregtuesit me shumicë ose personat e autorizuar prej tij duhet t'i shpërndajnë barnat vetëm te personat ose autoritetet e autorizuara për të kërkuar barna të tilla (tregtues me shumicë, farmaci, agjenci farmaceutike).

3. Këto praktika zbatohen për barnat përfundimtare, përfshirë këtu barnat biologjike dhe vaksinat. Kjo rregullore nuk zbatohet për produktet në bulk.

4. Këto praktika duhet të zbatohen si për barnat që janë pjesë e zinxhirit të shpërndarjes nga prodhuesi deri te pacienti, ashtu edhe për barnat të cilat janë në drejtim "të kundërt" të zinxhirit të shpërndarjes, si p.sh.: barnat e kthyera ose të tërhequra nga tregu.

Neni 15
Shpërndarja dhe dorëzimi i barnave

1. Siç shihet në skemën më poshtë bari përshkon rrugë të ndryshme transporti nga prodhuesi deri te pacienti. Në formën më të thjeshtë të shpërndarjes kemi dorëzimin e barit nga prodhuesi te klienti/pacienti. Gjithsesi më së shumti barnat pasi kalojnë zinxhirin e kontrollit nga prodhuesi hyjnë në një sistem kompleks që përfshin zinxhirin e shpërndarjes deri te pacienti. Tregtuesit me shumicë duhet të ndjekin kërkesat specifike të ruajtjes, shpërndarjes dhe dorëzimit ashtu siç është përcaktuar nga prodhuesi. Gjithashtu, në raste të veçanta, duhen plotësuar kushte specifike ruajtjeje dhe shpërndarjeje si për shembull: vaksinat, të cilat përcaktohen qartë nga prodhuesi. Në ndryshim nga dëmtimet si tronditja, thyerja apo të tjera si këto, rreziqet

termike janë më unike dhe kërkojnë një monitorim rigoroz. Ndaj është e detyrueshme që barnat me këtë lloj problematike të transportohen në secilën prej hallkave të shpërndarjes deri te dorëzimi te farmacia me makina që kanë sisteme monitorimi dhe kontrollimi të temperaturës.



2. Shpërndarja e barit nga prodhuesi te tregtuesi me shumicë.

a) Tregtuesit me shumicë, që presin të marrin barnat, duhet të sigurohen që këto barna kanë ardhur në vendin e duhur pa asnjë vonesë.

b) Tregtuesit me shumicë duhet të shqyrtojnë të tërë dokumentacionin në mënyrë që të sigurohen se bari nuk ka pasur asnjë vonesë gjatë transportimit dhe shpërndarjes në mënyrë që të sigurohen se bari nuk i është nënshtruar temperaturave ekstreme.

c) Magazinat doganore, të licencuara për ruajtjen e barnave, duhet të plotësojnë kushtet e ruajtjes të përcaktuara në këtë rregullore dhe janë objekt inspektimi nga institucionet përgjegjëse të inspektimit.

d) Mjetet e përdorura për të kryer transportimin e barit, sidomos për barnat që kërkojnë ruajtje në temperaturë të ulët, duhet të jenë të përshtatshme në mënyrë që të sigurojnë se bari është ruajtur në kushte të përshtatshme gjatë transportit dhe shpërndarjes deri në vendin e mbërritjes.

e) Tregtuesit me shumicë duhet të kujdesen që barnat janë dërguar në vendin e duhur pa asnjë dëmtim.

f) Mjetet e përdorura për të kryer transportimin e barnave që kërkojnë ruajtje në temperaturën e dhomës duhet të jenë të tilla që të sigurojnë ruajtjen e barit në temperatura as më të larta e as më të ulëta sesa ajo që thuhet në etiketim ose fletëudhëzues.

3. Shpërndarja nga prodhuesi te tregtuesi me shumicë e më pas në farmaci/agjenci farmaceutike

a) Tregtuesit me shumicë duhet të zbatojnë praktikën e rotacionit të stokut, bari i parë që ka ardhur dhe me datë skadence më të afërt është ai që del i pari për t'u dërguar te farmacia (FEFO), ashtu edhe bari i parë që ka hyrë në ambientet e ruajtjes është i pari që del jashtë (FIFO), duke shmangur në këtë mënyrë skadencën e barnave.

b) Farmacia, e cila merr barnat duhet të sigurohet që këto të fundit të dërgohen në vendin e përshtatshëm të ruajtjes, sipas mënyrës së përcaktuar nga prodhuesi.

c) Farmacisti duhet të shqyrtojë dokumentacionin shoqërues, në mënyrë që të sigurohet se bari nuk ka pasur asnjë vonesë gjatë transportimit dhe shpërndarjes në mënyrë që të sigurohet se bari nuk i është nënshtruar temperaturave ekstreme.

d) Mjetet e përdorura për të kryer transportimin e barit, sidomos për ato që kërkojnë ruajtje në temperaturë të ulët, duhet të jenë të përshtatshme, në mënyrë që të sigurojnë se bari është ruajtur në kushte të përshtatshme gjatë transportit dhe shpërndarjes deri në vendin e mbërritjes.

e) Farmacisti duhet të kujdeset që barnat janë dërguar në vendin e duhur pa asnjë dëmtim.

f) Mjetet e përdorura për të kryer transportimin e barnave që kërkojnë ruajtje në temperaturën e dhomës duhet të jenë të tilla që të sigurojnë ruajtjen e barit në temperatura as më të larta as më të ulëta se sa ajo që thuhet në etiketim ose fletëudhëzues.

g) Mjetet e përdorura për të kryer transportimin e barnave që kërkojnë ruajtje në temperatura të veçanta (barnat termolabile) duhet të jenë të tilla që të sigurojnë ruajtjen e cilësisë së barit dhe të përshtatshme për të zbatuar temperaturën e ruajtjes të shkruar në fletëudhëzuesin/fletëpërshkruesin shoqërues.

Neni 16
Importi

Duhet të ketë një numër të caktuar portash hyrëse nëpërmjet të cilave do të kryhet importi i barnave. Këto porta duhet të jenë në gjendje që të mundësojnë një ruajtje sa më të mirë të barnave. Qëndrimi i këtyre të fundit në doganë këshillohet të jetë për një kohë sa më të shkurtër.

Magazinat doganore të licencuara për ruajtjen e barnave duhet të plotësojnë kushtet e ruajtjes të përcaktuara në këtë rregullore dhe janë objekt inspektimi nga institucionet përgjegjëse të inspektimit.

Mund të ndërmerren të gjithë hapat e nevojshëm nga personi përgjegjës në mënyrë që të shihet nëse ka pasur ndonjë problem në ruajtjen ose transportin e barnave, deri në momentin e importit.

Në të tilla raste nëse shihet e arsyeshme, të behet vlerësimi i procesit nga personi përgjegjës për menaxhimin e cilësisë (farmacist).

Neni 17
Menaxhimi i cilësisë

Të gjitha palët e përfshira në shpërndarjen e barnave duhet të kenë një sistem të garantimit të cilësisë, ku të përcaktohen përgjegjësitë, proceset dhe parimet e menaxhimit të rrezikut lidhur me aktivitetet e tyre.

17.1 Sistemi i garantimit të cilësisë

Sistemi i garantimit të cilësisë duhet të jetë i dokumentuar dhe të jenë përcaktuar aktivitetet sipas funksionit për garantimin e cilësisë.

Duhet të caktohet një person përgjegjës i autorizuar (farmacist) dhe me përgjegjësi të mirëpërcaktuar për të siguruar që sistemi i garantimit të cilësisë të implementohet dhe të ruhet në kohë.

Personi përgjegjës për garantimin e cilësisë duhet të jetë indipendent në ushtrimin e përgjegjësive dhe të ketë autoritetin të kryejë funksionin e tij në mënyrë efektive. Ai mund të jetë edhe drejtuesi teknik i tregtuesit me shumicë.

Duhet të ekzistojë edhe një proces për rishikimin e sistemit të garantimit të cilësisë në mënyrë periodike.

Sistemi i garantimit të cilësisë duhet të sigurojë se:

a) Barnat janë ruajtur, shpërndarë ose eksportuar në mënyrë të tillë që të jenë kompliante me kërkesat e kësaj rregulloreje.

b) Përgjegjësitë menaxheriale janë të specifikuara qartë.

c) Barnat janë dorëzuar te porositësi i duhur.

ç) Deviacionet nga procedurat e përcaktuara janë hetuar dhe dokumentuar.

d) Menaxhimi efektiv i riskut.

dh) Menaxhimi i ankesave të barit.

e) Monitorimi dhe auditimi i brendshëm.

ë) Kontrolli i ndryshimit.

f) Menaxhimi i incidentit të barit dhe tërheqja.

g) Janë ndërmarrë veprimet parandaluese dhe korrigjuese (*CAPA*) të përshtatshme.

Neni 18
Personeli

I gjithë personeli i përfshirë në aktivitetet e shpërndarjes duhet të trajnohet mbi kërkesat e GDP-së (ligji "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", nenit 3, pika 66), Fletore Zyrtare nr. 132, datë 31.7.2014).

Duhet të ketë numër të përshtatshëm personash kompetentë të përfshirë në të gjitha fazat e shpërndarjes, roli dhe përgjegjësitë e secilit duhet të jenë të përcaktuara qartësisht në rregulloren e brendshme të funksionimit të tregtuesit me shumicë.

18.1 Personi përgjegjës

Distributori duhet të caktojë një person përgjegjës, i cili duhet të përmbushë të gjitha kërkesat dhe kualifikimet e përcaktuara.

Përgjegjësitë e personit përgjegjës për garantimin e cilësisë përfshijnë:

a) Sigurimin se një sistem për menaxhimin e cilësisë është implementuar dhe të mirëmbahet;

b) Fokusimin në menaxhimin e aktiviteteve të autorizuara dhe në cilësinë e saktësinë e të dhënave të regjistruara;

c) Sigurimin se programet trajnuese janë kryer dhe do të vazhdojnë të kryhen;

ç) Koordinimi dhe kryerja me saktësi e procedurave në rast të ndonjë tërheqje nga tregu farmaceutik e barit;

d) Sigurimin se çdo ankesë që mund të vijë prej klientëve të merret parasysh dhe të analizohet;

dh) Mbajtja e të dhënave për çdo detyrë që ka deleguar.

18.2 Pjesa tjetër e personelit

Personeli duhet të jetë i mjaftueshëm dhe kompetent për të kryer të gjitha detyrat, për të cilat subjekti është përgjegjës.

Struktura organizative e tregtuesve me shumicë duhet të jetë e paraqitur në një organigramë. Roli, përgjegjësitë dhe ndërveprimet e të gjithë personelit duhet të jenë të përcaktuara qartë.

Personat përgjegjës duhet të trajnohen në fillim dhe në mënyrë periodike në lidhje me rolin e tyre, bazuar në procedura të shkruara dhe në përputhje me një program trajnimi të shkruar për një shpërndarje të mirë të barnave.

Duhet të përcaktohen dhe vlerësohen procedura të përshtatshme lidhur me higjienën e personelit lidhur me aktivitetet që kryhen. Këto procedura duhet të përfshijnë shëndetin, higjienën dhe veshjen.

Neni 19

Godinat dhe pajisjet

19.1 Zonat e ruajtjes

Tregtuesit me shumicë duhet të disponojnë godina, instalime dhe pajisje të përshtatshme e të mjaftueshme në mënyrë që të sigurojnë ruajtje dhe shpërndarje të përshtatshme të barnave. Në veçanti godinat duhet të jenë të pastra, të thata dhe temperatura duhet të mbahet brenda limiteve të pranueshme.

Zonat e ruajtjes duhet të jenë të pajisura me ndriçim të përshtatshëm në mënyrë që të gjitha procedurat të kryhen në mënyrë të saktë dhe të duhur. Këto zona duhet të kenë akses të limituar të personelit, dhe në to duhet të hyjnë vetëm persona të autorizuar. Duhet t'i kushtohet rëndësi ruajtjes së materiale radioaktive dhe barnave ose materialeve të tjera të rrezikshme. Këto të fundit duhet të ruhen në vende të veçanta deri në momentin e shpërndarjes. Vendet ku kryhet dorëzimi dhe marrja e barnave duhet të jenë të tilla që t'i mbajnë këto të fundit larg ndikimit të kushteve atmosferike.

19.2 Kontrolli i temperaturës

Nevojiten pajisje dhe procedura të përshtatshme për të kontrolluar ambientin dhe mbarëvajtjen kushteve të ruajtjes e shpërndarjes së barnave. Faktorët ambientalë që merren në konsideratë përfshijnë temperaturën, dritën, lagështirën dhe pastërtinë apo higjienën e godinës.

Pajisjet monitoruese të temperaturës duhet të vendosen sipas rezultateve të një testimi paraprak të zonave të ruajtjes, duke garantuar kështu se janë pozicionuar në zonat që ka më shumë fluktuacione.

19.3 Pajisjet

Pajisjet dhe procedurat që mund të prekin ruajtjen dhe shpërndarjen e mirë të barnave duhet të vendosen, mirëmbahen dhe pastrohen në një standard të tillë që t'i përshtatet synimit për të cilin do të përdoret. Pajisjet që përdoren për të kontrolluar dhe monitoruar ambientin ku barnat ruhen, duhen kalibruar në intervale kohore të caktuara paraprakisht. Duhen vendosur sisteme alarmi për rastet kur ka devijim nga kushtet e mira të ruajtjes. Sisteme këto që edhe duhen testuar herë pas here në mënyrë që të sigurohemi për funksionalitetin e tyre.

19.4 Kontenitorët e dërgesës dhe etiketimi i kontenitorëve

1. Barnat duhet të ruhen dhe shpërndahen në kontenitorë që nuk kanë asnjë efekt të padëshiruar në cilësinë e barnave dhe që ofrojnë një mbrojtje sa më të mirë prej ndikimeve të jashtme, përfshirë këtu edhe kontaminimin.

2. Kontenitorët shpërndarës duhet të jenë të përshtatshëm për të mbajtur etiketa, të cilat përmbajnë informacion të hollësishëm mbi kushtet dhe kujdesin që duhet treguar për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e barit, në mënyrë që të sigurojnë se barnat ruhen të sigurta gjatë gjithë kohës.

3. Barnat duhet të ruhen dhe transportohen në përputhje me procedura të tilla si:

a) Bari të mos kontaminojë dhe të mos kontaminohet nga barnat e tjera.

b) Ndërmarrja e përkujdesjeve të veçanta në rast të ndonjë thyerje, vjedhje, pakujdesie apo derdhje të barnave të lëngshme.

c) Gjithashtu, duhen mirëmbajtur kushtet e duhura atmosferike, si për shembull, përdorimi i zinxhirit të ftohtë për barnat termolabile.

4. Tregtuesi me shumicë duhet të caktojë procedura të veçanta operacionale dhe mirëmbajtëse për të gjitha makineritë dhe pajisjet e përfshira në procesin e shpërndarjes përfshirë këtu pastrimin dhe masat e sigurisë.

5. Pastrimi i tyre duhet bërë në mënyrë të rregullt, duke përcaktuar paraprakisht intervalin kohor dhe nuk duhet të ketë papastërti të akumuluara, pesticide apo papastërti të ndryshme.

6. Makineritë dhe pajisjet që kanë pësuar një defekt nuk duhet të përdoren dhe duhet të etiketohen si të tilla ose të hiqen nga përdorimi.

7. Makineritë dhe pajisjet që përdoren për shpërndarje dhe ruajtje të barnave duhet të jenë të përshtatshme për funksionin që do të kryejnë dhe të parandalojnë ekspozimin e barit në kushte të cilat mund të dëmtojnë stabilitetin, integritetin e paketimit dhe të parandalojnë kontaminim të çfarëdo lloji.

8. Dizenjoja dhe përdorimi i makinerive dhe pajisjeve duhet të kenë si qëllim minimizimin e rreziqeve dhe të lejojnë pastrimin efektiv dhe/ose mirëmbajtjen në mënyrë që të shmanget kontaminimi, akumulimi i pluhurit ose papastërtive dhe/ose çdo efekti anësor në cilësinë e barit që do të shpërndahet.

9. Materialet e derdhura duhet të pastrohen sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që të parandalohet kontaminimi, kontaminimi i kryqëzuar dhe rreziqet e tjera. Procedura të shkruara duhet të ekzistojnë për zgjidhjen e këtyre situatave.

19.5 Marrja dhe dërgimi

1. Pajisjet dhe kontenitorët duhet të ngarkohen me kujdes dhe sistematikisht të zbatohet parimi "bari që ka skadencë më të afërt del i pari", në mënyrë që të kursehet kohë gjatë shkarkesës, të parandalohet dëmtim fizik dhe të reduktohen rreziqet. Kujdes i veçantë duhet treguar gjatë ngarkesës dhe shkarkesës së materialeve prej kartoni në mënyrë që të parandalohet dëmi.

2. Barnat nuk duhet të merren ose të dërgohen pas datës së skadencës ose shumë afër saj (aq sa kjo datë ka shumë mundësi të arrihet para se bari të përdoret nga pacienti).

19.6 Kualifikimi dhe validimi

1. Tregtuesit me shumicë duhet të identifikojnë cili është kualifikimi kyç i nevojshëm për pajisjet që do të përdoren apo validimi kyç i procedurave që do të kryhen në mënyrë që të sigurohet instalimi dhe funksionimi korrekt i tyre.

2. Qëllimi dhe përmbajtja e këtyre kualifikimeve ose validimeve duhet të kryhet në trajtën e një dokumenti për menaxhimin e riskut. Pajisjet dhe proceset duhet të jenë respektivisht të kualifikuara/ validuara para se të nisin funksionimin apo pas ndonjë riparimi ose ndryshimi mjaft të rëndësishëm që mund t'u ndodhë.

Neni 20

Dokumentacioni

1. Dokumentacioni përfshin të gjitha procedurat, instruksionet e shkruara, kontratat e regjistrimit në letër ose në formatin elektronik.

2. Dokumentacioni duhet të përfshijë informacione, si: datën, emrin e barit, sasinë e marrë, emrin dhe adresën e furnizuesit, klientit, numrin e lotit.

3. Dokumentacioni i shkruar duhet të parandalojë gabimet në komunikimin verbal gjatë shpërndarjes së barnave.

4. Dokumentacioni duhet të jetë mjaftueshëm i plotë për shpërndarjen dhe i qartë për personelin. Procedura duhet të jetë e aprovuar dhe e firmosur nga personi i autorizuar e jo me shkrim dore edhe nëse kjo e fundit është urgjente.

Neni 21

Barnat ndaj të cilave ka ankesa, janë kthyer, dyshohen të jenë/janë false apo janë të tërhequra nga tregu farmaceutik (heqja e autorizimit për tregtim)

Barnat ndaj të cilave ka ankesë, janë të kthyera apo dyshohen të jenë false ose janë tërhequr nga tregu farmaceutik duhet të regjistrohen dhe mirëmbahen me kujdes nëpërmjet një procedure të shkruar. Të dhënat duhet të jenë në dispozicion për autoritetet kompetente.

Neni 22

Ankesat

Ankesat duhen regjistruar me të gjitha detajet origjinale të tyre. Duhet bërë një dallim midis

ankesave që bëhen lidhur me cilësinë e barit apo me shpërndarjen e tij. Në rast të ndonjë ankese lidhur me cilësinë e tij apo me një defekt potencial të barit, prodhuesi dhe/ose mbajtësi i autorizimit për tregtim duhet të informohet jo më vonë se 24 orë.

Duhet caktuar një person që të kujdeset specifikisht për ankesat.

Neni 23
Barnat false

1. Tregtuesit me shumicë duhet të informojnë në mënyrë të menjëhershme autoritetet kompetente dhe mbajtësin e autorizimit për tregtim për çdo bar që ata e identifikojnë si të falsifikuar ose dyshojnë të jetë i tillë.

2. Barnat false të gjetura gjatë zinxhirit shpërndarës duhet të mbahen më vete nga barnat e tjera, në mënyrë që të shmanget çdo ngatërresë dhe konfuzion.

3. Ato duhet të etiketohen qartësisht si barna "jo për t'u shitur" dhe lidhur me to duhet të ndiqet një procedurë specifike, aktivitetet e së cilës duhet të dokumentohen dhe të dhënat duhen ruajtur.

Neni 24
Barna të kthyera

1. Barnat e kthyera duhet të ruhen dhe dorëzohen sipas një procedure të shkruar të bazuar në menaxhimin e riskut dhe duke marrë parasysh barin në fjalë, kërkesat specifike të ruajtjes që ai ka dhe kohën që ka kaluar që kur bari është dërguar fillimisht.

2. Kthimi duhet të kryhet në përputhje me ligjet kombëtare dhe marrëveshjet kontraktuale mes palëve.

3. Barnat që janë larguar prej mjediseve të tregtuesit me shumicë duhet të kthehen te stoku që është në gjendje për t'u shitur vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Barnat janë në gjendjen e tyre të pahapur me paketim dytësor të padëmtuar dhe në gjendje të mirë, nuk kanë skaduar dhe nuk janë tërhequr nga tregu.

b) Gjithashtu, për barnat që kërkojnë kushte specifike ruajtjeje dhe si p.sh.: temperaturë e ulët, kthimi në stokun për shitje mund të bëhet nëse ka prova të dokumentuara që bari është ruajtur nën kushtet e autorizuara të ruajtjes gjatë gjithë kohës. Nëse ka ndodhur ndonjë devijim atëherë duhet të kryhet vlerësimi i riskut.

4. Provat duhet të përfshijnë:

a) Shpërndarjen te klienti;

b) Ekzaminimin e barit;

c) Hapjen e paketimit transportues;

ç) Mbledhjen dhe kthimin te tregtuesi me shumicë;

d) Kthimin te frigoriferi që ndodhet në vendin ku kryhet shpërndarja.

Barnat e kthyera te stoku për shitje duhet të vendosen në mënyrë të tillë që sistemi FEFO të funksionojë në mënyrë efektive.

Neni 25
Barnat e tërhequra nga tregu farmaceutik

Të dhënat e procesit të shpërndarjes duhet të jenë në çdo moment që kërkohet të aksesueshme nga personi përgjegjës për tërheqjen nga tregu dhe duhet të përmbajnë informacion të mjaftueshëm mbi shpërndarjen dhe klientët që janë furnizuar në mënyrë direkte (adresë, numër telefoni dhe/ose numër faksi brenda dhe jashtë orarit të punës, numrin e lotit të paktën për barnat, për të cilat ekzistojnë udhëzime specifike të sigurisë dhe sasia e shpërndarë)/përfshirë ato për barnat e eksportuara dhe testerat e barnave. Progresi i tërheqjes nga tregu duhet të regjistrohet për një raport final.

Kjo rregullore u hartua në përputhje me udhëzimet e Bashkimit Evropian dhe të Organizatës Botërore të Shëndetësisë:

1. The European Medicines Agency's scientific guidelines on the quality of human medicinës;

2. Regulation (EC) No 726/2004 of the European Parliament and of the Council of 31 March 2004 laying down Community procedures for the authorisation and supervision of medicinal products for human and veterinary use and establishing a European Medicines Agency (OJ L 136, 30.4.2004, p. 1 - 33);

3. World Health Organization WHO Technical Report Series, No. 908, 2003 Annex 9 Guide to good storage practices for pharmaceuticals1;

4. US Pharmacopoeia 1079, Good Storage and Distribution Practices;

5. Guidelines of 5 November 2013 on Good Distribution Practice of medicinal products for human use (Text with EEA relevance) (2013/C 343/01);

6. Guidelines for the Storage of Essential Medicines and Other Health Commodities 2003;

7. PIC/S Guide to Good Distribution Practice for Medicinal Products.

SHTOJCË 1

1. Temperatura dimërore dhe verore e mjediseve të ruajtjes duhet të jetë në intervalet 20°C–26°C.

2. Tregtuesi me shumicë dhe farmacia duhet të pajisen me një matës lagështire, i cili duhet të jetë gjithmonë në vlerat 50%–60% lagështirë relative, në kushte normale të ruajtjes. Matësit e lagështirës duhet të jenë të kalibruara sipas procedurave në fuqi.

3. Gjithashtu, bazuar në etiketimin e barit ruajtja duhet bërë si më poshtë:

Në etiketim ose fletudhëzues	***Domethënia***
"Mos ruaj në temperaturë më të lartë se 30°C"	nga +2°C në +30°C
"Mos ruaj në temperaturë më të lartë se 25°C"	nga +2°C në +25°C
"Mos ruaj në temperaturë më të lartë se 15°C"	nga +2°C në +15°C
"Mos ruaj në temperaturë më të lartë se 8°C"	nga +2°C në +8°C
"Mos ruaj në temperaturë më të ulët se 8°C"	nga +8°C në +25°C
"Mbro nga lagështia"	Jo më shumë 50%–60% lagështirë relative në kushtet normale të ruajtjes

SEKSIONI I DYTË

ÇËSHTJA MALO KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 72359/11)

VENDIM

STRASBURG

22 maj 2018

I FORMËS SË PRERË

22.8.2018

Ky vendim është bërë i formës së prerë bazuar në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Malo kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Dytë), e mbledhur si një Dhomë e përbërë nga:

Robert Spano, *kryetar,*
Paul Lemmens,
Ledi Bianku,
Işıl Karakaş,
NebojšaVučinić,
Jon Fridrik Kjølbro,
Stéphanie Mourou-Vikström, *gjyqtarë,*
dhe Stanley Naismith, *kryesekretar,*

pasi diskutuan me dyer të mbyllura në datën 17 prill 2018,

shpall vendimin më poshtë, i cili u miratua në po atë datë:

PROCEDURA:

1. Çështja filloi me një kërkesë (nr. 72359/11) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur në Gjykatë, më 31 tetor 2011, sipas nenit 34, të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa"), nga një shtetas shqiptar, z. Vladimir Malo ("kërkuesi").

2. Kërkuesi u përfaqësua nga z. S. Luci, një avokat i cili ushtron profesionin në Tiranë. Qeveria shqiptare ("Qeveria") u përfaqësua nga agjenti i saj, në atë kohë, zj. L. Mandia, nga Avokatura e Shtetit.

3. Kërkuesi pretendonte, veçanërisht, se ishte shkelur neni 6 § 1 i Konventës.

2. Në datën 26 qershor 2012, kërkesa iu komunikua Qeverisë.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

5. Kërkuesi ka lindur në vitin 1975. Aktualisht, ai po vuan një dënim me burgim.

A. Grupi i parë i procedimeve

6. Në datën 9 korrik 2002, pas procedimeve në mungesë, Gjykata e Rrethit Gjirokastër e dënoi kërkuesin për vjedhje me armë mbetur në tentativë, vrasje nga neglizhenca dhe vrasje me

paramendim në lidhje me një tjetër vepër penale, dhe e dënoi atë me njëzet e pesë vjet burgim. Edhe tre të bashkëpandehur të tjerë, të cilëve iu pranuan kërkesat për gjykim të shkurtuar, u shpallën të fajshëm. Kërkuesi u përfaqësua nga një avokat i caktuar nga gjykata.

7. Në datën 7 tetor 2002, pas një apelimi nga tre të pandehurit e tjerë, Gjykata e Apelit Gjirokastër la në fuqi vendimin në mungesë të kërkuesit.

8. Në datën 10 tetor 2007, pas ekstradimit të kërkuesit në Shqipëri, Gjykata e Rrethit pranoi kërkesën e tij për rivendosje në afat. Gjykata e Rrethit, në arsyetimin e saj, parashtroi se shërbimi postar kishte konstatuar se kërkuesi jetonte në Itali dhe për pasojë nuk ishte bërë me dije për dënimin e tij.

B. Procedimet e rigjykimit

9. Në një datë të paspecifikuar, në tetor 2007, kërkuesi paraqiti apelimin e tij. Fillimisht, ai kërkoi që çështja e tij të rishqyrtohej veçantë nga ajo e bashkëfajtorëve të tij me arsyetimin se ai nuk kishte kërkuar përdorimin e procedurës së gjykimit të shkurtuar. Ai iu referua vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 2, të datës 29 janar 2003 (shih paragrafin 16 më poshtë). Së dyti, ai kërkoi që realizohej një shqyrtim i ri i të dhënave në praninë e tij dhe të pyeteshin disa dëshmitarë. Së treti, ai pohoi se autoritetet nuk e kishin njoftuar në lidhje me procedimet gjyqësore të mbajtura në gjykatën e shkallës së parë.

10. Në datën 17 dhjetor 2007, Gjykata e Apelit Gjirokastër e la në fuqi dënimin në mungesë të kërkuesit. Gjykata vendosi se kërkuesi nuk kishte paraqitur të dhëna të reja për të ndryshuar rezultatin e atyre procedimeve. Kërkesa e tij ishte drejtuar ndaj vlerës provuese të të dhënave, të cilat tashmë ishin shqyrtuar dhe për to ishte marrë një vendim. Për lënien në fuqi të dënimit, gjykata u mbështet në të dhënat mjeko-ligjore të nxjerra në vitin 1997 dhe 1999, si edhe në dëshmitë e dhëna në vitin 2001 dhe 2002. Në vijim, gjykata pohoi se kërkuesi ishte njoftuar rregullisht, sepse autoritetet kishin lëshuar një njoftim publik. Së fundmi, ajo vërejti se procedura e shkurtuar ishte zbatuar në mënyrë të barabartë për të gjithë të pandehurit, në përputhje me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë, të datës 29 janar 2003 (shih më poshtë "Praktika përkatëse gjyqësore vendëse"). Ndarja e çështjeve nuk mund të merrej në konsideratë, sepse gjykata e rrethit nuk kishte marrë një vendim mbi këtë çështje.

11. Në një datë të paspecifikuar, kërkuesi paraqiti një apelim kundër vendimit të Gjykatës së Apelit. Ai u ankua se ishte shkelur e drejta e tij për marrjen në pyetje të dëshmitarëve dhe për rishqyrtimin e të dhënave. Ai theksoi faktin se në apelimin e tij Gjykata e Apelit kishte kërkuar marrjen e të dhënave, duke përfshirë paradën e identifikimit, marrjen në pyetje të një personi të katërt, i cili kishte qenë i pranishëm gjatë ngjarjeve, një përballje të drejtpërdrejtë midis tij dhe të bashkëpandehurve të tjerë dhe kështu me radhë. Ai e kishte pasur të pamundur t'i mblidhte vet këto të dhëna; vetëm gjykatat ose prokurori mund ta bënte një gjë të tillë. Gjithashtu, kërkuesi theksoi ankesat e tjera që kishte ngritur gjatë çështjes së tij në Gjykatën e Apelit.

12. Në datën 5 mars 2010, Gjykata e Lartë e pushoi apelin, me konstatimin se i mungonin shkaqet për apelim sipas parashikimit të ligjit.

13. Në datën 21 shkurt 2011, kërkuesi paraqiti një apelim kushtetues në Gjykatën Kushtetuese.

14. Në datën 9 maj 2011, avokati i kërkuesit u njoftua mbi vendimin e Gjykatës Kushtetuese, se apelimi i tij ishte i papranueshëm.

II. LIGJI DHE PRAKTIKA PËRKATËSE VENDËSE

15. Ligji dhe praktika përkatëse vendëse në at kohë, për sa u përket procedimeve në mungesë, është përshkruar në detaje në vendimet *Shkalla kundër Shqipërisë* (nr. 26866/05, §§ 28–35, 10 maj 2011), dhe *Izet Haxhia kundër Shqipërisë* (nr. 34783/06, §§ 19–42, 5 nëntor 2013).

16. Praktika gjyqësore përkatëse vendëse, në lidhje me realizimin e procedurës së gjykimit të shkurtuar, në kohën konkrete, përshkruhet në detaje në vendimin *Cani kundër Shqipërisë* (nr. 11006/06, §§ 34–35, 6 mars 2012).

17. Parashikimet të cilat kanë lidhje me fushën e veprimit të shqyrtimit të një apelimi nga Gjykata e Apelit, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor nga Gjykata e Apelit dhe kompetencat e një gjykate apeli,

përshkruhen në detaje në vendimin *Mulosmani kundër Shqipërisë* (nr. 29864/03, § 106, 8 tetor 2013).

18. Parashikimet përkatëse në lidhje me procedurën e apelimit në Gjykatën e Lartë përshkruhen në detaje në vendimin *Çaush Driza kundër Shqipërisë* (nr. 10810/05, § 53, 15 mars 2011).

LIGJI

I. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

19. Bazuar në nenin 6 §§ 1 dhe 3 (a), (b), (c) dhe (d) të Konventës, kërkuesi u ankua në lidhje me gjykimin e tij në mungesë. Po ashtu, ai u ankua se nuk ishte lejuar të shqyrtonte dëshmitë ose të kërkonte shqyrtimin e të dhënave në procedimet e rigjykimit. Këto dispozita parashikojnë si më poshtë:

"1. Në përcaktimin e… çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësish… nga [një] … gjykatë…

…

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a) Të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

b) T'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c) Të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d) Të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës…".

A. Pranueshmëria

20. Gjykata vëren se kjo ankesë nuk është qartazi e pabazuar në fakte sipas kuptimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës. Në vijim, ajo vëren se ajo nuk është e papranueshme për ndonjë shkak tjetër. Për këtë arsye, duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Meritat

21. Kërkuesi këmbënguli se procedimet ndaj tij kishin qenë të padrejta përderisa ishin zhvilluar në mungesë. Ai nuk ishte njoftuar personalisht për ndonjë akt dhe as nuk kishte marrë ndonjë informacion gjatë hetimit penal dhe procedimeve gjyqësore. Gjatë rigjykimit, gjykatat vendëse nuk kishin mundur të merrnin të dhëna të reja dhe kërkuesi nuk kishte mundur të merrte në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe në emrin e tij.

22. Qeveria pranoi se kërkuesi ishte gjykuar dhe dënuar në mungesë. Megjithatë, Qeveria argumentoi se procedimet vendëse nuk kishin qenë të padrejta. U ritheksuan konstatimet e vendimit të Gjykatës së Apelit të datës 17 dhjetor 2007, se kërkuesi ishte njoftuar rregullisht nga autoritetet. Po ashtu, u pohua se ai ishte përfaqësuar nga një avokat i caktuar nga gjykata dhe se të drejtat e tij për mbrojtje ishin respektuar.

23. Në vijim, Qeveria argumentoi se rivendosja në afat ishte një mjet efikas për një gjykim në mungesë, se një përcaktim i ri i akuzës penale u konsiderua një gjykim i ri. Qeveria iu referua neneve 425, 427 dhe 428, të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohej një shqyrtim i apelimit nga Gjykata e Apelit dhe rifillimi i shqyrtimit gjyqësor të një çështje nga Gjykata e Apelit, ku parashikoheshin kompetencat e gjykatës së apelit (shih paragrafin 17 më sipër). Duke u kthyer në çështjen aktuale, u vërejt se ankesat e kërkuesit kryesisht ishin drejtuar drejt vlerës provuese të të dhënave dhe realizimit të procedimeve përpara gjykatës së shkallës së parë. Për këtë arsye, Gjykata e Apelit, me anë të vendimit të saj të datës 17 dhjetor 2007, kishte vendosur rregullisht mbi meritat e çështjes dhe vlerës provuese të të dhënave. Ajo kishte gjykuar se bazuar në të dhënat e përftuara gjatë grupit të parë të procedimeve, kërkuesi ishte fajtor për akuzat.

24. Gjykata vëren se parimet e përgjithshme, në lidhje me procedimet në mungesë përshkruheshin në vendimin *Sejdovic kundër Italisë* ([DHM], nr. 56581/00, §§ 81–95, GJEDNJ 2006–II).

25. Më tej, Gjykata thekson se garancitë në paragrafin 3, të nenit 6, janë aspekte specifike të së drejtës për një gjykim të drejtë parashikuar në paragrafin 1. Nën këto rrethana, Gjykata e mendon të panevojshme shqyrtimin e relevancës së paragrafit 3 të çështjes, duke qenë se pretendimet e kërkuesit, në çdo rast, përmblidhen në një ankesë se procedimet ishin të padrejta. Për këtë arsye, Gjykata do ta

përqendrojë shqyrtimin e saj në këtë pikë (shih *Shkalla*, cituar më sipër, § 67).

26. Në çështjen konkrete, palët nuk debatuan për faktin se kërkuesi u gjykua dhe u dënua në mungesë. Nuk u provua se kërkuesi kishte mjaftueshëm dijeni për procedimet ligjore ndaj tij. Faktikisht, u konstatua se ai ishte bërë me dije për dënimin në mungesë, pas ekstradimit të tij në Shqipëri (shih paragrafët 6–8 më sipër).

27. Gjykata rithekson se megjithëse procedimet të cilat kishin ndodhur në mungesë të të akuzuarit, në vetvete nuk pajtohen me nenin 6 të Konventës, mohimi i drejtësisë gjithsesi nuk ka dyshim se ndodh në rastin kur një person i dënuar në mungesë nuk mund të përfitojë nga gjykata, e cila e ka dëgjuar, një përcaktim të ri të meritave të akuzës, në lidhje me ligjin dhe faktin, në rastin kur nuk konstatohet se ai ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur dhe për t'u vetëmbrojtur (shih *Sejdovic*, cituar më sipër, § 82). Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata do të shqyrtojë, nëse procedimet e rigjykimit paraqisnin detyrimin për mundësinë e një përcaktimi të ri faktik dhe ligjor të akuzës penale ndaj kërkuesit.

28. Gjykata vëren se Gjykata e Rrethit Gjirokastër kishte pranuar pretendimin e kërkuesit për rivendosje në afat, sipas nenit 147 të KPP-së. Në vijim, Gjykata vëren se pas apelimit të kërkuesit, Gjykata e Apelit Gjirokastër shqyrtoi meritat e çështjes dhe la në fuqi dënimin në mungesë të kërkuesit. Ajo u bazua në të dhënat e marra gjatë grupit të parë të procedimeve. Gjithashtu, Gjykata theksoi se siç mund të vihet re në vendimin e Gjykatës së Apelit, dhe në apelimet e kërkuesit në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë, avokati i kërkuesit kishte paraqitur kërkesa të qarta për një shqyrtim të ri të të dhënave, si edhe të lejohej të merrte në pyetje dëshmitarët. Megjithatë, Gjykata e Apelit nuk bëri ndonjë përcaktim të ri për akuzat penale ndaj kërkuesit. Gjykata e Apelit konstatoi se kërkuesi nuk paraqiti të dhëna të reja për ndryshimin e rezultatit të procedimeve të mbajtura në mungesë, pa dhënë ndonjë arsye tjetër, çfarëdo, pamundësinë e tij për të mbledhur të dhëna të reja dhe për të thirrur dëshmitarët, siç ishte kërkuar nga kërkuesi (krahaso dhe nxirr ndryshimet *Jones kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vend.), nr. 30900/02, 9 shtator 2003, dhe *Makarenko kundër Rusisë*, nr. 5962/03, § 139, 22 dhjetor 2009). Ajo thjesht përsëriti arsyetimin dhe konstatimet në grupin e parë të procedimeve.

29. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se kërkuesi në realitet nuk pati mundësinë të përfitonte një përcaktim të ri të themelit të akuzave ndaj tim nga një gjykatë gjatë procedimeve, mbështetur në garancitë për drejtësi sipas nenit 6.

30. Për këtë arsye, është shkelur neni 6 § 1 i Konventës.

II. SHKELJE TJETËR E PRETENDUAR E KONVENTËS

31. Së fundi, kërkuesi u ankua edhe për mungesë të arsyeve në vendimin e Gjykatës së Lartë.

32. Gjithashtu, Gjykata thekson se sipas praktikës së saj gjyqësore të mirë-përcaktuar, reflektimi i një parimi të lidhur me administrimin e duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave dhe tribunaleve duhet të përcaktojnë në mënyrën e duhur arsyet mbi të cilat janë bazuar (shih *Moreira Ferreira kundër Portugalisë* (nr. 2) [DHM], nr. 19867/12, § 84, GJEDNJ 2017; shih gjithashtu *Marini kundër Shqipërisë*, nr. 3783/02, § 105, 18 dhjetor 2007). Shkalla deri ku zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të variojë sipas natyrës së vendimit dhe duhet të përcaktohet sipas rrethanave të çështjes (shih *García Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, § 26, GJEDNJ 1999–I). Pa kërkuar një përgjigje të detajuar për çdo argument paraqitur nga kërkuesi, ky detyrim presupozon se palët në procedimet gjyqësore mund të presin të marrin një përgjigje specifike dhe eksplicite për argumentet, të cilat janë vendimtare për rezultatin e procedimeve (shih, midis vendimeve të tjera, *Ruiz Torija kundër Spanjës*, 9 dhjetor 1994, §§ 29–30, seritë A nr. 303–A, dhe *Higgins dhe të Tjerët kundër Francës*, 19 shkurt 1998, §§ 42–43, *Raportet e gjykimeve dhe vendimeve* 1998–I). Për më tepër, në çështjet e lidhura me ndërhyrjen në të drejtat e siguruara sipas Konventës, Gjykata kërkon të përcaktojë nëse arsyet e ofruara për

vendimet e dhëna nga gjykatat vendëse janë automatike ose stereotipa të tyre (shih, *mutatis mutandis*, *Paradiso dhe Campanelli kundër Italisë* [DHM], nr. 25358/12, § 210, GJEDNJ 2017 (ekstrakte).

33. Gjykata vëren se në lidhje me këtë gjë, kërkuesi apeloi në Gjykatën e Lartë me po të njëjtat arsye, si edhe në apelimin në Gjykatën e Lartë. Gjykata është e mendimit se arsyet e kufizuara dhënë nga Gjykata e Lartë në formulat *de plano* të vendimeve të saj, gjithsesi tregonin padyshim se kërkuesi nuk kishte ngritur një nga pikat e ligjit parashikuar nga dispozita përkatëse vendëse, e cila është pranimi i kërkesës së pranueshmërisë për rivendosje në afat (shih paragrafin 18 më sipër). Gjykata vëren se në rastin kur Gjykata e Lartë refuzon të pranojë një çështje me arsyetimin se nuk janë përcaktuar arsyet ligjore për këtë çështje, një arsyetim shumë i kufizuar mund të përmbushë kërkesat e nenit 6 të Konventës (shih *Marini*, cituar më sipër, § 106).

34. Sipas arsyeve më sipër, rezulton se kjo pjesë e kërkesës është qartazi e pabazuar në fakte dhe duhet të kundërshtohet sipas nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

35. Neni 41 i Konventës parashikon:

"Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar."

36. Kërkuesi nuk paraqiti pretendim për kompensim të drejtë.

37. Gjykata thekson konstatimet e saj në vendimin *Shkalla* (cituar më sipër, §§ 77–79), dhe *Izet Haxhia* (cituar më sipër, § 70) për faktin se kur një kërkues është dënuar në shkelje të të drejtave të tij ose të saj, siç garantohet në nenin 6 të Konventës, forma më e përshtatshme e korrigjimit është të sigurohet se kërkuesi është vendosur sa më shumë të jetë e mundur në pozicionin që do të kishte pasur, në rast se do të ishte respektuar ky parashikim. Forma më e përshtatshme e korrigjimit, në parim, do të ishte një gjykim i ri ose një rifillim i procedimeve, në rast se një gjë e tillë do të kërkohej.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. I deklaron ankesat në lidhje me padrejtësinë e procedimeve në mungesë, të pranueshme dhe pjesën tjetër të kërkesës të papranueshme;

2. Gjykon se është shkelur neni 6 § 1 i Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, në datën 22 maj 2018, bazuar në Rregullin 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Stanley Naismith Kryesekretar — **Robert Spano** Kryetar

SEKSIONI I DYTË

ÇËSHTJA MUÇA KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 57456/11)

VENDIM

STRASBURG

22 maj 2018

I FORMËS SË PRERË

22.8.2018

Ky vendim është bërë i formës së prerë bazuar në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Muça kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Dytë), e mbledhur së një Dhomë e përbërë nga:

Robert Spano, *kryetar,*
Paul Lemmens,
Ledi Bianku,
Işıl Karakaş,
Nebojša Vučinić,
Jon Fridrik Kjølbro,
Stéphanie Mourou-Vikström, *gjyqtarë,*
dhe Stanley Naismith, *kryesekretar,*

pasi diskutuan me dyer të mbyllura në datën 17 prill 2018,

shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja filloi me një kërkesë (nr. 57456/11) kundër Republikës së Shqipërisë, paraqitur në Gjykatë me datë 25 gusht 2011, mbështetur në nenin 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa"), nga një shtetas shqiptar, z. Blerim Muça ("kërkuesi").

2. Kërkuesi u përfaqësua nga z. V. Muzina, një avokat i cili ushtron detyrën në Durrës. Qeveria shqiptare ("Qeveria") u përfaqësua nga agjenti i saj, në atë kohë, znj. L. Mandia nga Avokatura e Shtetit.

3. Në datën 25 gusht 2011, kërkuesi dërgoi një kërkesë në Gjykatë, me pretendimin se ishte shkelur neni 6 § 1 i Konventës. Kërkesa arriti në Gjykatë më 31 gusht 2011.

4. Në datën 21 nëntor 2011, kërkuesi i dërgoi Gjykatës një kërkesë tjetër, të ngjashme me atë që tashmë u dërgua në gusht 2011. Kërkesa arriti në Gjykatë në datën 24 nëntor 2011.

5. Në datën 26 qershor 2012, kërkesa iu komunikua Qeverisë.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Kërkuesi ka lindur në vitin 1970 dhe jeton në Tiranë.

7. Në një datë të paspecifikuar, ndaj kërkuesit dhe dy të bashkakuzuarve të tjerë u ngritën procedime penale për vrasje të paramenduar. Si pasojë, kërkuesi u arrestua nga autoritetet.

8. Në datën 21 korrik 1998, kërkuesi adresoi një shkresë në Gjykatën e Rrethit Kavajë ("Gjykata e Rrethit") dhe prokurorit të rrethit Kavajë ("prokurori i rrethit"), duke pohuar se kishte angazhuar A., një avokat, për ta përfaqësuar atë përpara prokurorit të rrethit gjatë hetimit dhe gjatë procedimeve gjyqësore. Rezulton se kërkuesi e ka shkruar këtë shkresë teksa ishte në paraburgim.

9. Në datën 1 nëntor 1999, Gjykata e Rrethit e shpalli kërkuesin të pafajshëm dhe urdhëroi lirimin e tij. Ai kishte ndjekur gjykimin dhe ishte mbrojtur nga A., avokati i zgjedhur prej tij. Dy të bashkakuzuarit e tjerë u shpallën fajtorë dhe u dënuan.

10. Në një datë të paspecifikuar, dy të bashkakuzuarit e tjerë dhe prokurori apeluan ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit, i datës 1 nëntor 1999.

11. Në një datë të paspecifikuar, kërkuesi u largua nga Shqipëria. Rezulton se kërkuesi nuk ishte informuar për apelimet e dy të bashkakuzuarve të tjerë dhe të prokurorit, por mesa duket, A. ishte informuar për një gjë të tillë.

12. Në datën 28 shkurt 2000, Gjykata e Apelit Durrës ("Gjykata e Apelit") anuloi vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe e ridërgoi çështjen për rishqyrtim. Kërkuesi u përfaqësua nga A., në mungesë të tij.

13. Në datën 21 prill 2000, Gjykata e Lartë e kundërshtoi apelimin e kërkuesit paraqitur nga A. kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, të datës 28 shkurt 2000.

14. Në datën 26 dhjetor 2000, gjatë procedimeve të rigjykimit, Gjykata e Rrethit e shpalli kërkuesin fajtor në mungesë për vrasje të paramenduar dhe e dënoi atë me njëzet e tre vjet burgim. Kërkuesi u përfaqësua nga avokati A. (shih paragrafin 9). Vendimi pohonte se A. ishte caktuar nga gjykata. Dy të bashkakuzuarit e tjerë apeluan.

15. Në datën 10 shtator 2001 dhe 14 dhjetor 2001, Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë, respektivisht, lanë në fuqi vendimin e datës 26 dhjetor 2000. Gjatë këtyre procedimeve, kërkuesi u përfaqësua nga një avokat i ri i caktuar nga gjykata.

16. Në datën 14 prill 2004, nëna e kërkuesit punësoi një avokat tjetër, K., për të përgatitur një kërkesë për rishikim. Nga vendimi i Gjykatës së Lartë, i datës 9 korrik 2010 (shih paragrafin 18 më poshtë) dhe nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, i datës 25 shkurt 2011 (shih paragrafin 21 më poshtë) rezulton se kërkesa për rishikim u kundërshtua nga Gjykata e Lartë. Nuk gjendet asnjë kopje e vendimit në fjalë të Gjykatës së Lartë në dosjen e çështjes.

17. Në datën 8 korrik 2005, kërkuesi u informua për shpalljen e tij fajtor në mungesë, nga familjarët e tij. Ai paraqiti një kërkesë për rivendosje në afat, kundër vendimit të datës 26 dhjetor 2000, me argumentin se nuk ishte informuar kurrë për shpalljen e tij fajtor në

mungesë, sepse jetonte jashtë vendit. Kërkuesi përfaqësohej nga K., si mbrojtësi i tij.

18. Në datën 4 nëntor 2005, 29 shtator 2006 dhe 9 korrik 2010, respektivisht, Gjykata e Rrethit dhe Gjykata e Apelit e pushuan dhe Gjykata e Lartë e rrëzoi, kërkesën e tij. Gjykatat vendëse gjykuan se kërkuesi duhej të ishte bërë me dije për procedimet, përderisa ai ishte përfaqësuar nga një avokat i zgjedhur prej tij, A., i cili ishte informuar në lidhje me apelimin e prokurorit, dhe sepse nëna e tij kishte caktuar një avokat për të përgatitur një kërkesë për rishikim. Gjithashtu, ato gjykuan se çështja tashmë ishte shqyrtuar në të gjitha shkallët dhe se vendimet e tyre ishin ende në fuqi.

19. Gjyqtari A.H., i cili kishte qenë anëtar i trupit gjykues të Gjykatës së Rrethit, që kishte shpallur vendimin e datës 26 dhjetor 2000, ishte pjesë i trupit gjykues edhe në Gjykatën e Rrethit, në datën 4 nëntor 2005, i cili pushoi kërkesën e kërkuesit. Gjyqtarët V.C. dhe SH.M., të cilët kishin qenë anëtarë të trupit gjykues të Gjykatës së Apelit, e cila më 10 shtator 2001 la në fuqi vendimin e datës 26 dhjetor 2000, ishin pjesë edhe të trupit gjykues të Gjykatës së Apelit, i cili pushoi apelimin e tij, në datën 29 shtator 2006.

20. Në një datë të specifikuar, kërkuesi, i përfaqësuar nga avokati i tij, dorëzoi një ankesë kushtetuese në lidhje me pretendimin për padrejtësi gjatë procedimeve në mungesë dhe mungesës së paanshmërisë së Gjykatës së Rrethit dhe Gjykatës së Apelit.

21. Në datën 16 mars 2011, avokati i kërkuesit u informua në lidhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 25 shkurt 2011, për pushimin e apelimit kushtetues të kërkuesit. Gjykatë Kushtetuese, duke theksuar se A. dhe nëna e kërkuesit ishin bërë me dije për procedimet gjyqësore, u shpreh se nuk kishte pasur rrethana të veçanta, që ta pengonin kërkuesin t'i ndiqte procedimet personalisht. Ajo nuk shqyrtoi pretendimin e kërkuesit për paanshmëri nga ana e Gjykatës së Rrethit dhe Gjykata e Apelit.

II. LIGJI DHE PRAKTIKA PËRKATËSE VENDËSE

22. Ligji dhe praktika përkatëse vendëse, në periudhën në fjalë, përshkruhen në detaje në vendimet *Shkalla kundër Shqipërisë* (nr. 26866/05, §§ 28–35, 10 maj 2011) dhe *Izet Haxhia kundër Shqipërisë* (nr. 34783/06, §§ 19–42, 5 nëntor 2013).

LIGJI

I. PRETENDIME PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

23. Kërkuesi u ankua për padrejtësi të procedimeve në mungesë të tij, si edhe për mungesën e paanshmërisë së gjyqtarëve, të cilët morën pjesë në shqyrtimin e çështjes së tij, pasi ishte përfshirë në raundin e parë të procedimeve. Ai iu referua nenit 6 § 1 të Konventës, i cili, në pjesët e lidhura me situatën, parashikon si më poshtë:

"1. Në përcaktimin e … çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësish … nga [një] …gjykatë e pavarur dhe e paanshme..."

24. Qeveria e mohoi faktin të kishte pasur ndonjë shkelje të këtij parashikimi.

A. Pranueshmëria

25. Qeveria argumentoi se kërkesa ishte dorëzuar përtej afatit kohor prej gjashtë muajsh parashikuar në Konventë, pasi kërkuesi e kishte paraqitur kërkesën në datën 24 nëntor 2011.

26. Kërkuesi këmbënguli se kërkesa ishte paraqitur brenda afatit kohor prej gjashtë muajsh.

27. Gjykata vëren se kërkuesi e kishte dërguar formularin e kërkesës në datë 25 gusht 2011 dhe ky i fundit mbërriti në Gjykatë me postë në datën 31 gusht 2011. Bazuar në materialin dërguar përpara tij, Gjykata nuk gjen asnjë arsye për të konstatuar se kërkesa është dërguar përtej afatit. Formulari i kërkesës së dytë dërguar më 21 nëntor 2011, ishte një dokument shtesë, i cili nuk ndikon në kërkesën fillestare. Për këtë arsye, Gjykata rrëzon kundërshtimin e Qeverisë.

28. Gjykata vëren se kjo ankesë nuk është qartazi e pabazuar në fakte, sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës. Në vijim, ajo vëren se kërkesa nuk është e papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Për këtë arsye, duhet e deklaruar e pranueshme.

B. Meritat

1. Procedimet në mungesë

29. Kërkuesi parashtroi se ai ishte larguar nga Shqipëria pasi Gjykata e Rrethit e liroi atë sipas vendimit të datës 1 nëntor 1999. Ai nuk kishte pasur dijeni për procedimet ndaj tij. Për këta arsye, autoritetet e gjykuan dhe e shpallën atë fajtor në mungesë. Gjithashtu, ai deklaroi se dijenia e nënës së tij në lidhje me këto procedime, nuk i bënte të drejta procedimet për aq kohë sa ai nuk kishte dijeni për to. Gjithashtu, ai debatoi për faktin se familjarët e tij kishte paraqitur një kërkesë për rishikim (shih paragrafët 16, 18 dhe 21 më sipër). Gjykatat vendëse nuk kishin marrë në konsideratë vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 30, të datës 17 qershor 2010 (shih *Izet Haxhia*, cituar më sipër, § 35).

30. Qeveria pranoi se kërkuesi ishte gjykuar dhe shpallur fajtor në mungesë. Megjithatë, Qeveria argumentoi se procedimet vendëse nuk kishin qenë të padrejta. Kërkuesi ishte përfaqësuar nga një avokat i zgjedhur prej tij. Ai ishte i pranishëm në procedimet përpara Gjykatës së Rrethit, e cila e kishte deklaruar të pafajshëm në datën 1 nëntor 1999. Avokati i tij A. Ishte informuar për apelimin e paraqitur ndaj atij vendimi. A. kishte qenë po ashtu i pranishëm në procedimet përpara Gjykatës së Apelit, e cila, më 28 shkurt 2000, e kishte ridërguar çështjen për rishqyrtim. A. po ashtu, kishte apeluar në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të Gjykatës së Apelit të datës 28 shkurt 2000.

31. Gjithashtu, Qeveria parashtroi se familjarët e kërkuesit kishin pasur dijeni për procedimet. Ata kishin qenë rregullisht të pranishëm në procedimet gjyqësore ose kishin angazhuar rregullisht avokatë për të përfaqësuar kërkuesin. Në të vërtetë, nëna e tij kishte punësuar një avokat për të përgatitur kërkesën për rishikimin e vendimit të formës së prerë, në emër të kërkuesit. Për më tepër, angazhimi i të njëjtit avokat – K. – kishte treguar se vullneti i kërkuesit kishte qenë i njëjtë si ai i nënës së tij.

32. Në parashtrimet e tyre shtesë, Qeveria pohoi se kërkuesi kishte dhënë miratimin për t'u gjykuar në mungesë, sepse kishte bërë me dije për gjykimin ndaj tij. Vendimi i Gjykatës së Rrethit, i datës 1 nëntor 1999 nuk kishte qenë i formës së prerë, dhe për këtë arsye ishte i hapur për t'u apeluar. Pretendimi i kërkuesit për rivendosje në afat ishte pushuar me arsyetimin se asgjë nuk e kishte penguar të merrte pjesë në procedime.

33. Gjykata thekson se parimet e përgjithshme në lidhje me procedimet në mungesë përcaktoheshin në vendimin *Sejdovic kundër Italisë* ([DHM], nr. 56581/00, §§ 81–95, GJEDNJ 2006–II). Në vijim, Gjykata thekson se edhe pse procedimet të cilat zhvillohen në mungesë të të pandehurit në vetvete nuk pajtohen me nenin 6 të Konventës, gjithsesi, drejtësia mohohet në rastin kur një person i dënuar në mungesë nuk mund të marrë nga gjykata, e cila ka dëgjuar çështjen e tij, një përcaktim të ri të themelit të akuzës, si për ligjin edhe për faktin, për aq kohë sa nuk është përcaktuar se ai ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur dhe për t'u vetëmbrojtur (shih *Sejdovic*, cituar më sipër, § 82, dhe *Hokkeling kundër Holandës*, nr. 30749/12, § 58, 14 shkurt 2017).

34. Duke u rikthyer në çështjen konkrete, Gjykata thekson se kërkuesi kishte qenë i pranishëm dhe ishte asistuar nga një avokat i zgjedhur prej tij në procedimet në shkallën e parë (ndryshe nga vendimi *Shkalla*, cituar më sipër, në të cilin kërkuesi nuk ishte informuar për procedimet), në fund të të cilit gjykata e shpalli të pafajshëm dhe urdhëroi lirimin e tij. Pasi u lirua, kërkuesi u largua jashtë vendit. Megjithatë, pas apelimeve të të bashkakuzuarve të tjerë dhe të prokurorit, kërkuesi u shpall fajtor në mungesë. Në këtë aspekt, gjykata thekson se edhe pse avokati i zgjedhur prej tij vijoi ta përfaqësonte në apel, nuk mund të nënkuptohet se avokati po vepronte sipas udhëzimeve eksplicite të kërkuesit. Në fakt, gjatë procedimeve të rigjykimit, kërkuesin vazhdoi ta përfaqësonte i njëjti avokat, pasi ai ishte caktuat nga gjykata (krahaso dhe bëj ndryshimin me vendimin *Medenica kundër Szvicrës*, nr. 20491/92, GJEDNJ 2001–VI). Në procedimet e rigjykimit në vijim, kërkuesi u përfaqësua nga një tjetër avokat i zgjedhur nga gjykata. Qeveria nuk parashtroi ndonjë provë për të kundërtën.

35. Së fundmi, bazuar në dokumentet në dosjen e çështjes, Gjykata nënvizon se nuk mund të thuhet se caktimi i një avokati nga familjarët për përgatitjen e një kërkese për rishikim, kishte miratimin ose pëlqimin e kërkuesit. Nuk mund të nënkuptohet se nisur nga fakti se kërkuesi u mbrojt nga një avokat i caktuar nga nëna e tij, kërkuesi ka pasur dijeninë e duhur për apelimin dhe procedurat e rigjykimit.

36. Për të gjitha parashtrimet e mësipërme, Gjykata konstaton se nuk provohet se kërkuesi ka pasur mjaftueshëm dijeni për procedimet e apelimit ose se ka pasur mjaftueshëm dijeni për procedimet e rigjykimit ndaj tij. Më tej, nuk ka asnjë tregues në dosjen e çështjes për faktin se autoritetet kanë bërë çdo përpjekje për ta njoftuar. Gjithashtu, nuk është provuar se ai ka autorizuar në mënyrë eksplicite ose të nënkuptuar veprimet e familjarëve të tij ose të avokatit të tij, ose se ka hequr dorë qartazi nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjykatë, duke iu fshehur qëllimisht drejtësisë. në vijim, Gjykata thekson se kërkuesi ka paraqitur pa sukses një kërkesë për rishikim në afat (shih *Shkalla*, cituar më sipër § 75, dhe *Izet Haxhia*, cituar më sipër, § 63), për këtë arsye, ai mjet rezultoi se nuk ishte efikas.

37. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se kërkuesi nuk pati mundësinë të përfitonte një përcaktim të ri të themelit të akuzave ndaj tij nga një gjykatë, çka do t'i mundësonte të vijonte më tej me çështjen e tij në procedime bazuar në garancitë për drejtësi të nenit 6.

38. Për këtë arsye, është shkelur neni 6 i Konventës.

2. Paanshmëria e Gjykatës së Rrethit dhe Gjykatës së Apelit

39. Gjithashtu, kërkuesi u ankua, mbështetur në nenin 6 § 1, për mungesë paanshmërie të trupave gjykues të Gjykatës së Rrethit gjatë procedimeve të datës 4 nëntor 2005 dhe të Gjykatës Apelit në procedimet e datës 29 shtator 2006.

40. Gjykata thekson se ekzistenca e paanshmërisë sipas qëllimeve të nenit 6 § 1 duhet të përcaktohet mbi një kontroll subjektiv ku duhet marrë në konsideratë nëse një gjyqtar i caktuar ka pasur një bindje ose sjellje personale, që nënkupton nëse gjyqtari ka pasur ndonjë paragjykim personal ose ka qenë i anshëm në një çështje të caktuar; dhe sipas një kontrolli objektiv, që do të thotë duke përcaktuar nëse vet tribunali, dhe midis aspekteve të tjerë, nëse përbërja e tij kanë ofruar mjaftueshëm garanci për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në lidhje me paanshmërinë e tij (shih *Micallef kundër Maltës* [DHM], nr. 17056/06, § 93, GJEDNJ 2009).

41. Duke u kthyer në çështjen konkrete, Gjykata vëren se trupat gjykues të Gjykatës së Rrethit, në datën 26 dhjetor 2000 dhe të Gjykatës së Apelit, në datën10 shtator 2001, shqyrtuan çështjen e kërkuesit sipas meritave dhe e shpallën fajtor në mungesë. Më tej,. Gjykata nënvizon se disa anëtarë të këtyre trupave gjykues (Gjyqtarët A.H., V.C. dhe Sh.M.), ishin edhe pjesë e trupit gjykues gjatë procedimeve në Gjykatën e Rrethit, në datën 4 nëntor 2005, edhe gjatë procedimeve në Gjykatën e Apelit, në datën 29 shtator 2006, për shqyrtimin e pretendimit të kërkuesit për rivendosje në afat.

42. Në lidhje me kontrollin subjektiv, Gjykata vëren se kërkuesi nuk debatoi për paanshmërinë personale të Gjyqtarëve A. H., V.C. dhe Sh.M.

43. Në lidhje me kontrollin objektiv, duhet të përcaktohet nëse, pa marrë në konsideratë sjelljen personale të gjyqtarëve, ekzistojnë fakte të konstatuar, të cilët mund të ngrenë dyshime për paanshmërinë e tyre. Gjykata thekson se trupi gjykues i Gjykatës së Rrethit, gjatë procedimeve në datën 29 shtator 2006, nuk e shqyrtoi çështjen bazuar në themelin e dënimit. Gjithashtu, nuk u arrit ndonjë përfundim mbi fajësinë e kërkuesit (shih *Fey kundër Austrisë*, 24 shkurt 1993, § 34, seritë A nr. 255-A).

44. Për sa më sipër, duke supozuar se neni 6 përkon me procedurat e rivendosjes në afat, Gjykata nuk gjykon se shqetësimet që mund të ketë pasur kërkuesi për paanshmërinë e trupit gjykues të Gjykatës së Rrethit të datës 4 nëntor 2005 dhe të trupit gjykues të Gjykatës së Apelit më 29 shtator 2006, të jenë të justifikueshme objektivisht. Në këtë mënyrë, rezulton se kjo pjesë e kërkesës është qartazi e pabazuar në fakte dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

45. Neni 41 i Konventës parashikon:

"Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar."

A. Dëmi

46. Kërkuesi kërkoi 15,000 euro (EUR) për dëmin monetar dhe 50,000 euro për dëmin jomonetar.

47. Qeveria parashtroi se kërkesat e kërkuesit nuk bazoheshin në fakte.

48. Gjykata nuk dallon ndonjë lidhje rastësore midis shkeljes së konstatuar dhe dëmit monetar të pretenduar; për këtë arsye e rrëzon pretendimin.

49. Në lidhje me kërkesat për dëm jomonetar, Gjykata thekson konstatimet e saj në vendimin *Shkalla* (cituar më sipër, §§ 77–79), dhe *Izet Haxhia* (cituar më sipër, § 70) se në rastin kur një kërkues është dënuar për shkelje të të drejtave të tij ose të saj sipas garancive të nenit 6 të Konventës, forma më e përshtatshme e korrigjimit do të ishte garantimi që kërkuesi të vendoset sa më shumë të jetë e mundur në pozitën në të cilën do të kishte qenë, në rast se do të zbatohej ky parashikim. Në parim, forma më e përshtatshme e korrigjimit do të ishte një gjykim i ri ose rifillim i procedimeve në rast se kjo do të kërkohej. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundimin se konstatimi i një shkelje në vetvete përbën mjaftueshëm kompensim të drejtë për dëmin jomonetar të vuajtur nga kërkuesi.

B. Kostot dhe shpenzimet

50. Kërkuesi kërkoi edhe 20,000 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra. Ai nuk paraqiti dokumente mbështetëse.

51. Qeveria i rrëzoi pretendimet e kërkuesit.

52. Sipas Rregullit 60 të Rregullave të Gjykatës, një kërkuesi i jepet e drejta për rimbursim të kostove dhe të shpenzimeve vetëm për aq kohë sa provohet se ato janë bërë faktikisht dhe duheshin bërë domosdoshmërisht, dhe sipas kuantit janë të arsyeshme (shih *Gjyli kundër Shqipërisë*, nr. 32907/07, § 72, 29 shtator 2009). Në mungesë të dokumenteve mbështetëse të paraqitura nga kërkuesi, Gjykata e rrëzon kërkesën për kostot dhe shpenzimet.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. E deklaron ankesën në lidhje me padrejtësinë në procedimet e zhvilluara në mungesë të pranueshme dhe pjesën tjetër të kërkesës të papranueshme;

2. Gjykon se është shkelur neni 6 § 1 i Konventës;

3. Gjykon se konstatimi i shkeljes përbën në vetvete kompensim të drejtë për dëmin jomonetar të vuajtur nga kërkuesi;

4. Pushon pretendimin e kërkuesit për kompensim të drejtë.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, në datën 22 maj 2018, mbështetur në Rregullin 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullave të Gjykatës.

Stanley Naismith Kryesekretar — **Robert Spano** Kryetar

SEKSIONI I DYTË

ÇËSHTJA HYSI KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 72361/11)

VENDIM

STRASBURG

22 maj 2018

I FORMËS SË PRERË

22.8.2018

Ky vendim është bërë i formës së prerë bazuar në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Hysi kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Dytë), e mbledhur si një Dhomë, e përbërë nga:

Robert Spano, *kryetar,*
Paul Lemmens,
Ledi Bianku,
Işıl Karakaş,
NebojšaVučinić,
Jon Fridrik Kjølbro,
Stéphanie Mourou-Vikström, *gjyqtarë,*

dhe Stanley Naismith, *kryesekretar i Seksionit,*

pasi diskutoi me dyer të mbyllura, më 17 prill 2018,

shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja filloi me një kërkesë (nr. 72361/11) kundër Republikës së Shqipërisë, paraqitur në Gjykatë, në datën 7 nëntor 2011, sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa"), nga shtetasi shqiptar, z. Ardit Hysi ("kërkuesi").

2. Kërkuesi u përfaqësua nga z. A. Meta dhe Znj. N. Meta, avokatë, të cilët e ushtrojnë profesionin në Tiranë. Qeveria shqiptare ("Qeveria") u përfaqësua nga agjenti i saj në atë kohë, zj. L. Mandia nga Avokatura e Shtetit.

3. Kërkuesi u ankua mbështetur në nenin 6 §§ 1 dhe 3 (c) dhe (d) të konventës, për gjykimin e tij në mungesë.

4. Më 26 qershor 2012, kërkesa iu komunikua Qeverisë.

5. Qeveria kundërshtoi kategorikisht shqyrtimin e çështjes nga një Komitet (neni 28 § 1 (b)), me argumentin se përfshinte elementë të cilët nuk ishin objekt i praktikës gjyqësore të afirmuar të Gjykatës. Gjykata e pranon kundërshtimin.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Kërkuesi ka lindur në Qesarat, Tepelenë, në vitin 1977. Aktualisht, ai po vuan një dënim me burgim.

7. Në datën 14 janar dhe 10 nëntor 2005, në vijim të procedimeve në mungesë, Gjykata e Rrethit Gjirokastër dhe Gjykata e Apelit, respektivisht, e dënuan kërkuesin për vjedhje të mbetur në tentativë me pasojë vdekje, në bashkëpunim me të tjerë dhe e dënoi atë me 17 vjet burgim. Ky vendim u bë i formës së prerë në datën 9 shkurt 2007, pasi Gjykata e Lartë pushoi një apelim nga avokati i kërkuesit. Rezulton se kërkuesi u përfaqësua gjatë gjithë procedurave gjyqësore nga një avokat i caktuar nga familja e tij.

8. Rezulton se në datën30 mars 2007, kërkuesi u ekstradua nga Greqia në Shqipëri.

9. Në datën 3 maj 2007, Gjykata e Rrethit Gjirokastër pranoi një kërkesë nga kërkuesi për rivendosje në afat dhe ai paraqiti një apelim ndaj dënimit të tij në mungesë.

10. Në datën 12 nëntor 2007, Gjykata e Apelit Gjirokastër, teksa ricilësoi akuzat ndaj kërkuesit bazuar në të dhënat e marra gjatë procedimeve në mungesë, la në fuqi dënimin e kërkuesit, duke vendosur se ai ishte bërë *res judicata.*

11. Me anë të një vendimi të formës së prerë, të datës 7 tetor 2009, Gjykata e Lartë la në fuqi dënimin ndaj kërkuesit, siç edhe u shpall me anë të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjirokastër të vitit 2005, duke vendosur se ai ishte bërë *res judicata* dhe se faktet dhe ligji në çështje ishin shqyrtuar më herët. Në vijim, Gjykata vërejti se nuk duhet të ishte dhënë rivendosja në afat përderisa çështja ishte bërë *res judicata.*

12. Në datën 21 shkurt 2011, kërkuesi paraqiti një apelim kushtetues në Gjykatën Kushtetuese ndaj vendimit të Gjykatës së Lartë, duke u ankuar, *inter alia,* për faktin se gjykatat vendëse nuk i kishin dhënë mundësinë për një përcaktim të ri faktik dhe ligjor të akuzës.

13. Në datën 9 maj 2011, avokati i kërkuesit u njoftua për vendimin e Gjykatës Kushtetuese për të pushuar apelimin e tij.

II. LIGJI DHE PRAKTIKA PËRKATËSE VENDËSE

14. Ligji dhe praktika përkatëse vendëse në atë kohë, në lidhje me procedimet në mungesë janë përshkruar në detaje në çështjen *Shkalla kundër Shqipërisë* (nr. 26866/05, § § 28–35, 10 maj 2011), dhe *Izet Haxhia kundër Shqipërisë* (nr. 34783/06, §§ 19–42, 5 nëntor 2013).

15. Parashikimet përkatëse, në atë kohë, në lidhje me qëllimin e shqyrtimit të një apelimi nga Gjykata e Apelit, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor të çështjes nga Gjykata e Apeli dhe kompetencat e një gjykate apeli u përshkruan në detaje në çështjen *Mulosmani kundër Shqipërisë* (nr. 29864/03, § 106, 8 tetor 2013).

16. Në datën 30 mars 2017, Kodi i Procedurës Penale ("KPP") u ndryshua me anë të ligjit nr. 35/2017 dhe dispozitat e reja hynë në fuqi në datën 1 gusht 2017. Dispozitat e reja të zbatueshme në çështjen konkrete parashikojnë si më poshtë:

Neni 147 – Rivendosje në afat (ndryshuar në vitin 2017)

"Prokurori, i pandehuri, viktima, viktima akuzuese dhe palët private rivendosen në afatin e caktuar kur provojnë se nuk kanë pasur mundësi ta respektojnë afatin për shkak të rastit fator ose të forcës madhore.

2. Rivendosja në afat nuk lejohet më shumë se një herë për secilën palë për çdo shkallë të procedimit.

3. Kërkesa për rivendosjen në afat paraqitet brenda dhjetë ditëve nga zhdukja e faktit që përbënte rast fator ose forcë madhore. Për kërkesën vendos organi që procedon në kohën e paraqitjes së saj.

4. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve. …".

Neni 410 – Ankimi i të pandehurit (ndryshuar në vitin 2017)

"2. Kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i autorizuar posaçërisht nga i pandehuri me akt përfaqësimi të lëshuar në format e parashikuara nga ligji ose me deklarim në seancë.".

Neni 420 § 1 – Rivendosja në afatin e ankimit (shtuar në vitin 2007)

"1. Palët rivendosen në afatin e ankimit kur provojnë se nuk kanë pasur mundësi ta respektojnë afatin për shkak të rastit fajtor ose të forcës madhore ...

2. Kur gjykimi është zhvilluar në mungesë [si rezultat i tërheqjes të pandehurit nga ndjekja e procedimeve], i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin.

3. Kërkesa për rivendosjen në afat paraqitet brenda dhjetë ditëve nga zhdukja e faktit që përbënte rast fator ose forcës madhore. Për rastin e parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, kërkesa duhet të paraqitet brenda dhjetë ditëve, nga dita kur i pandehuri ka marrë dijeni efektivisht për vendimin. Rivendosja në afat nuk lejohet më shumë se një herë për secilën palë dhe për çdo shkallë të procedimit.

8. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve..".

Neni 450 – Rastet e rishikimit (ndryshuar në vitin 2017)

"1. Rishikimi [i një vendimi të formës së prerë] mund të kërkohet:

a) kur faktet e vëna në themel të vendimit nuk pajtohen me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë;

b) kur [gjykata e cila ka dhënë] vendimin është bazuar në një vendim të gjykatës civile ose administrative, i cili është revokuar më pas;

c) kur pas vendimit kanë dalë ose janë zbuluar prova të reja, të cilat vetëm ose së bashku me ato që janë vlerësuar njëherë, tregojnë se vendimi është i gabuar;

d) kur vërtetohet se vendimi është dhënë si pasojë e falsifikimit të akteve të gjykimit ose të një fakti tjetër të parashikuar nga ligji si vepër penale;

e) kur Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka miratuar një vendim që e bën të domosdoshëm rishqyrtimin e çështjes ...

f) kur ekstradimi i të dënuarit të gjykuar në mungesë jepet me kushtin e shprehur të rigjykimit të çështjes. Kërkesa për rishikim mund të paraqitet brenda tridhjetë ditëve nga data kur personi është ekstraduar ...

g) kur personi është gjykuar në mungesë ... dhe kërkon rigjykimin e çështjes. Kërkesa për rishikim paraqitet brenda tridhjetë ditëve nga data e marrjes dijeni [për gjykimin në mungesë] ...".

III. MATERIAL I KËSHILLIT TË EVROPËS

17. Në datën 21 shtator 2017, Komiteti i Ministrave dha vendimin për ekzekutimin e vendimit në çështjen *Shkalla* (cituar më sipër), në lidhje, midis çështjeve të tjera, moshapjen e procedimeve në mungesë nga autoritet shqiptare. Ky vendim, i cili u miratua në takimin e tij të 1265-të, për sa ka të bëjë me çështjen, parashikonte:

"Deputetët

1. me kënaqësi vunë re masat individuale të marra në këto çështje, veçanërisht se të gjithë kërkuesit kanë pasur mundësinë efikase për të përfituar rihapjen e procedimeve të kundërshtuara, si edhe faktin se për ata kërkues që kanë bërë kërkesën, u dhanë garancitë se procedimet e reja ose ishin realizuar ose do të realizoheshin në përputhje me kërkesat e nenit 6 të Konventës, dhe se teksa këto procedime do të ishin në vijim, kërkuesit mund të kërkon lirimin; duke marrë në konsideratë, sipas rastit, se për këtë grup çështjesh nuk kërkohen masa të tjera individuale;

...

3. i inkurajuan autoritetet të finalizonin shpejtë reformën në proces e sipër në sistemin gjyqësor për të parandaluar shkeljet e mëtejshme në lidhje me mungesën e garancive ndaj procedimeve penale të mbajtura në mungesë, të drejtën për mbrojtjen e dikujt në gjykatë dhe paraqitjen e dëshmitarëve; vendosi të vijonin me shqyrtimin e këtyre masave në çështjet *Caka, Cani dhe Izet Haxhia* dhe të mbyllte çështjet e ngjashme *Berhani* dhe *Shkalla"*.

18. Në datën 7 dhjetor 2017, Komiteti i Ministrave mori vendimin për ekzekutimin e vendimit në çështjen *Izet Haxhia* (cituar më sipër) në lidhje me, midis çështjeve të tjera, moshapjen e procedimeve në mungesë nga ana e autoriteteve shqiptare. Ky vendim, i cili u miratua në takimin e tij të 1302-të, parashikonte, për sa ka të bëjë me çështjen, si më poshtë:

"Deputetët

...

2. mirëpritën masat e përgjithshme të ndërmarra, veçanërisht, ndryshimet legjislative në Kodin e Procedurës Penale, miratuar më 30 mars 2017, në lidhje me garancitë

për procedimet penale në mungesë, të drejtën për mbrojtjen e dikujt në gjykatë dhe paraqitjen e dëshmitarëve; mori në konsideratë se masat e përgjithshme të miratuara janë mjaftueshëm për të parandaluar shkelje të ngjashme dhe se në këtë mënyrë këto çështje mund të mbyllen".

19. Në vendimin e po të njëjtës ditë, Komiteti i Ministrave parashikoi për sa ka të bëjë me çështjen, si më poshtë:

"Deputetët

...

Duke sjellë në vëmendjen e Qeverisë së paditur detyrimin, sipas Nenit 46, paragrafi 1 i Konventës, të pajtohet me të gjitha vendimet e formës së prerë, në çështjet në të cilat ka qenë palë, dhe se ky është një detyrim për shlyerjen e çdo shume të përcaktuar nga Gjykata, miratimin nga autoritetet e Shtetit të paditur, sipas kërkesës:

- të masave individuale për t'i dhënë fund shkeljeve dhe për eliminimin e pasojave të tyre, për të arritur sa më shumë të jetë e mundur *restitutio in integrum*;".

20. Me anë të këtij vendimi, Komiteti i Ministrave mbylli shqyrtimin e vendimit të çështjes *Izet Haxhia.*

LIGJI

SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

21. Kërkuesi u ankua mbështetur në nenin 6 §§ 1 dhe 3 (c) dhe (d) të Konventës për padrejtësinë në procedimet e mbajtura në mungesë. Ato parashikime përcaktojnë si më poshtë:

"1. Në përcaktimin e … çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësish … nga [një] …gjykatë…

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

…

c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d) të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës…".

22. Qeveria i kundërshtoi pretendimet e kërkuesit.

A. Pranueshmëria

23. Qeveria parashtroi se Shteti shqiptar ishte në procesin e reformës në drejtësi, me qëllim përmirësimin e legjislacionit dhe garantimin e të drejtave themelore të individëve. Në kuadër të programit të reformës, Shteti kishte bërë ndryshime thelbësore në legjislacionin penal me anë të ligjit nr. 35/2017, të datës 30 mars 2017, më konkretisht me anë të neneve 410 dhe 449–451 të KPP-së dhe njohjen e një dispozite të re, neni 420 § 1. Gjithashtu, Qeveria parashtroi se Komiteti i Ministrave kishte mbyllur shqyrtimin e vendimeve në çështjet *Shkalla kundër Shqipërisë* nr. 26866/05, 10 maj 2011) dhe *Izet Haxhia kundër Shqipërisë* (nr. 34783/06, nëntor 2013).

24. Gjithashtu, Qeveria parashtroi se mangësitë e brendshme të konstatuara në çështjet *Shkalla* dhe *Izet Haxhia* (cituar më sipër), të cilat po ashtu, lidhen me çështjen konkrete, ishin adresuar me anë të masave të miratuara në kuadër të reformës në drejtësi, për të parandaluar shkelje të ngjashme në të ardhmen, të lidhura me padrejtësinë e procedimeve penale.

25. Kërkuesi nuk paraqiti ndonjë vërejtje. Megjithatë, ai ruajti në fakt korrespondencën me Gjykatën, duke treguar interesin e tij në ndjekjen e kërkesës.

26. Gjykata rithekson se vlerësimi nëse mjetet vendëse janë shteruar, normalisht realizohet duke iu referuar datës në të cilën është paraqitur kërkesa. Megjithatë, ky rregull ka përjashtime, të cilat mund të justifikohen me anë të rrethanave të veçanta të secilës çështje (shih për shembull *Baumann kundër Francës*, nr. 33592/96, § 47, GJEDNJ 2001–V (ekstrakte). Në këtë kontekst, Gjykata do të shqyrtojë nëse Qeveria ka paraqitur ndonjë mjet efikas në vitin 2017, të cilin do të mund ta përdorte kërkuesi, duke marrë në konsideratë referencën eksplicite të Qeverisë tek ato parashikime, çka gjykohet si e përshtatshme nga Gjykata për trajtimin si kundërshtim paraprak.

27. Fillimisht, Gjykata vëren se rivendosja në afat parashikuar në nenin e ri 420 § 1 të KPP-së përcakton se një kërkesë e tillë duhet të paraqitet brenda dhjetë ditëve nga data në të cilën i pandehuri, në mënyrë efikase, "kërkon të bëhet me dije" për vendimin. Gjithashtu, rivendosja në afat nuk mund të jepet më shumë se një herë për secilën palë dhe në secilën fazë të procedimeve. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundimin se duke qenë se kërkuesi është informuar për dënimin e tij

në mungesë, më 30 mars 2007, si data e fundit (shih paragrafin 8 më sipër), ai nuk mund ta përdorë një mjet të tillë.

28. Së dyti, Gjykata vëren se sipas nenit 450, nënparagrafët (f) dhe (g) të ndryshuar, kërkesa për rishikimin e një vendimi të formës së prerë duhet të paraqitet brenda tridhjetë ditëve që nga data në të cilën është ekstraduar personi, ose nga data në të cilën i pandehuri është vënë në dijeni për gjykimin në mungesë. Sipas rastit, për sa u përket rrethanave të çështjes, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesi nuk mund ta përdorë atë mjet, gjithsesi.

29. Së treti, Gjykata vëren se nuk ka asnjë parashikim të ri në KPP, që i lejon gjykatat vendëse të shqyrtojnë pa afat çështjet e vjetra, për të cilat gjykimi është kryer në mungesë.

30. Së katërti, Gjykata vëren se Qeveria nuk paraqiti ndonjë praktikë gjyqësore vendëse, ku parashikimet e reja të KPP-së ishin zbatuar në rrethana të ngjashme me ato në çështjen konkrete.

31. Së fundmi, Gjykata vëren se Komiteti i Ministrave ishte i mendimit se masat e përgjithshme të miratuara ishin të mjaftueshme për të parandaluar shkelje të ngjashme. Megjithatë, për aq kohë sa çështja nuk u përmend në rastet e *Shkallës* dhe *Izet Haxhisë* (cituar më sipër), Komiteti i Ministrave nuk vendosi se masat e përgjithshme të miratuara do të parandalonin shkelje të ngjashme për sa u përket çështjeve të vjetra në të cilat gjykimi ishte zhvilluar në mungesë, ku afatet kohore për përdorimin e mjeteve të garantuara sipas parashikimeve të reja të KPP-së tashmë kishin përfunduar. Gjithashtu, Gjykata i referohet rëndësisë së masave individuale për t'i dhënë fund shkeljeve të konstatuara dhe për të fshirë pasojat e tyre, për të arritur sa më shumë të ishte e mundur *restitutio in integrum* (shih paragrafin 18 më sipër).

32. Për të gjitha arsyet e mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se mjetet e reja të njohura në vitin 2017, të cilat mund të jenë efikase për situatat pas hyrjes në fuqi të parashikimeve të reja të KPP-së, nuk zbatohen për çështjen konkrete. Sipas rastit, Gjykata rrëzon kundërshtimin paraprak të Qeverisë.

33. Gjykata vëren se kërkesa nuk është qartazi e pabazuar në fakte, sipas kuptimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës. Në vijim, ajo vëren se ajo nuk është e papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Për këtë arsye ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Meritat

34. Në formularin e kërkesës së tij, ankuesi pohoi se procedimet ndaj tij kishin qenë të padrejta, sepse ishin zhvilluar në mungesë. Ai nuk kishte hequr asnjëherë dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjykatë. Ai nuk ishte bërë me dije për procedimet ndaj tij dhe nuk kishte mbajtur kontakte me anëtarët e familjes së tij. Ai ishte përpjekur të largohej për në Greqi, sepse kishte frikë nga gjakmarrja nga ana e familjes së viktimës. Më tej, ai pohoi se duhej të ishte bërë një përcaktim i ri i akuzës penale pasi Gjykata e Rrethit kishte pranuar kërkesën e tij për rivendosje në afat, më 3 maj 2007. Ky detyrim ndaj autoriteteve parashikohej në nenin 147 të KPP-së dhe u konfirmua nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 30, të datës 17 qershor 2010 (shih "Ligjin dhe praktikën përkatëse vendëse", në paragrafin 14 më sipër).

35. Qeveria e pranoi faktin se kërkuesi ishte gjykuar dhe dënuar në mungesë. Megjithatë, argumentoi se procedimet vendëse nuk kishin qenë të padrejta. Gjithashtu, Qeveria u kundërpërgjigj se kërkuesi ishte përfaqësuar ose nga një avokat i caktuar nga familja ose nga një avokat i caktuar nga gjykata dhe se të drejtat e tij për mbrojtje ishin respektuar. Në vijim, Qeveria parashtroi se një përcaktim i ri i akuzës penale ishte marrë në konsideratë si një gjykim i ri. Ata iu referuan neneve 425, 427 dhe 428 të KPP-së, të cilët parashikonin një shqyrtim të një apeli nga Gjykata e Apelit dhe rifillimin e shqyrtimit gjyqësor si çështje nga Gjykata e Apelit dhe përcaktuan kompetencat e kësaj gjykatë (shih paragrafin 15 më sipër). Gjithashtu, u parashtrua se pretendimi i kërkuesit për rivendosje në afat bazohej në të njëjtat argumente si ato të parashtruara nga mbrojtja e tij gjatë gjykimit në mungesë.

36. Gjykata vëren se parimet e përgjithshme në lidhje me procedimet në mungesë janë përshkruar në *Sejdovic kundër Italisë* ([DHM], nr. 56581/00, §§ 81–95, GJEDNJ 2006-II). Në

vijim, Gjykata vëren se megjithëse procedimet të cilat mbahen në mungesën e të akuzuarit në vetvete nuk janë në mospërputhje me nenin 6 të Konventës, mohimi i drejtësisë gjithsesi vjen pa dyshim në rastin kur një person i dënuar në mungesë nuk mundet që të përfitojë nga gjykata, e cila ka dëgjuar çështjen e tij, një caktim të ri të meritave të akuzës, në lidhje me ligjin dhe faktin, në rastin kur nuk është përcaktuar se ai ose ajo ka hequr dorë nga e drejta e tij ose e saj për t'u paraqitur dhe për t'u vetëmbrojtur (shih *Sejdovic*, cituar më sipër, § 82 dhe *Hokkeling kundër Holandës*, nr. 30749/12, § 58, 14 shkurt 2017).

37. Në vijim, Gjykata vëren se garancitë në paragrafin 3 të nenit 6 janë aspekte specifike të së drejtës për një gjykim të drejtë parashikuar në paragrafin 1. Në këto rrethana, Gjykata e konsideron të panevojshme shqyrtimin e lidhjes së paragrafit 3 të çështjes, përderisa pretendimet e kërkuesit, në çdo rast, përmblidhen në ankesën se procedimet ishin të padrejta. Për këtë arsye, ajo do ta përmbyllë shqyrtimin e saj në atë pikë (shih *Shkalla,* cituar më sipër, § 67).

38. Në çështjen konkrete, palët nuk debatuan në lidhje me faktin se kërkuesi ishte gjykuar dhe dënuar në mungesë. Nuk u tregua se kërkuesi kishte mjaftueshëm njohuri për procedimet ligjore ndaj tij. Në fakt, u vërtetua se ai nuk ishte informuar për dënimin në mungesë deri në datën 30 mars 2007, kur u dorëzua tek autoritetet shqiptare (shih paragrafin 8 më sipër). Por gjithashtu, nuk u provua se ai kishte autorizuar në mënyrë eksplicite ose të nënkuptuar veprimet e pjesëtarëve të familjes së tij për apelimin ose se hoqi dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjykatë pa mëdyshje duke iu shmangur qëllimisht drejtësisë (shih *Izet Haxhia*, cituar më sipër, § 63). Gjithashtu, edhe pse Gjykata e Rrethit Gjirokastër pranoi pretendimin e kërkuesit për rivendosje në afat, sipas nenit 147 të KPP-së, Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë, në vijim, nuk bënë një përcaktim të ri për akuzat ndaj tij. Ato theksuan se dënimi i tij fillestar ishte bërë *res judicata*, pa dhënë asnjë arsye tjetër çfarëdo qoftë për refuzimin tyre për të bërë një përcaktim të ri të këtij dënimi (shih *Sejdovic*, cituar më sipër, §§ 82–85).

39. Bazuar në sa më sipër, Gjykata konstaton se kërkuesi nuk pati mundësinë të përfitonte një përcaktim të ri të meritave të akuzave ndaj tij nga një gjykatë, e cila do ta kishte dëgjuar në procedime në përputhje me garancitë e drejtësisë së nenit 6 § 1.

40. Për këtë arsye, ka pasur nj shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës si për realizimin e procedimeve në mungesë dhe për mohimin që i është bërë kërkuesit për një shqyrtim të ri të meritave të çështjes.

II. ZBATIM I NENIT 41 TË KONVENTËS

41. Neni 41 i Konventës parashikon:

"Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar."

42. Kërkuesi nuk paraqiti një kërkesë për kompensim të drejtë.

43. Gjykata rithekson konstatimet e saj në çështjen *Shkalla* (cituar më sipër, §§ 77–79), dhe *Izet Haxhia* (cituar më sipër, § 70), për faktin se në rastin kur një kërkues është dënuar në shkelje të të drejtave të tij ose të saj, siç garantohet në nenin 6 të Konventës, forma më e përshtatshme e korrigjimit është të sigurohet se kërkuesi është vendosur sa më shumë të jetë e mundur në pozicionin që do të kishte pasur, në rast se do të ishte respektuar ky parashikim. Forma më e përshtatshme e korrigjimit, në parim, do të ishte një gjykim i ri ose një rifillim i procedimeve, në rast se një gjë e tillë do të kërkohej.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. *E deklaron* kërkesën të pranueshme;

2. *Gjykon* se është shkelur neni 6 § 1 i Konventës;

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, në datën 22 maj 2018, bazuar në Rregullin 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Stanley Naismith	**Robert Spano**
Kryesekretar	Kryetar

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 308 lekë